

Fshati Akllap ka pasur  
104 shtëpi, sot gati se  
është boshatisur IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

VITI 2019, VITI  
I VENDIMIT  
HISTORIK F. 10



Shkruan:  
Hashim THAÇI



USHTRIA E KOSOVËS DHE  
ALI AHMETI F. 11

Ismet SYLEJMANI

PEZULLOHET GREVA E  
MJEKËVE F. 6

ZËVENDËSPRESIDENTI I  
PE-SË VIZITON XHAMINË NË  
DRENAS, BËN HOMAZHE  
EDHE NË PREKAZ F. 10

## EKONOMI

MINATORËT E 'TREPÇËS' NË  
GREVË, KËRKOJNË RITJE TË  
PAGAVE F. 9

## KULTURË

MESAZHI NGA EVROPA F. 8

Nga Shkelzen UKËHAXHAJ

## SPORT

TË FILLOJNË SA MË SHPEJT  
PUNIMET PËR NDËRTIMIN E  
STADIUMIT KOMBËT F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH HARADINAJ IFAQE 4-5

## Zgjedhjet e parakohshme nuk janë në interes të vendit

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme në këtë vit nuk është në interes të vendit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se viti 2019 nuk do të jetë i lehtë për Kosovën pasi do të përballet me procesin e dialogut me Serbinë dhe Gjykatën Speciale. Haradinaj ka ftuar dy subjektet më të mëdha opozitare, LDK-në dhe Lëvizjen Vetëvendosje, që të bashkohen në procesin e dialogut, duke thënë se askush nuk duhet të frikësohet nga ky proces. Kryeministri ka folur edhe për raportet që Qeveria ka krijuar me PSD-në. Sipas tij, zyrtarët e këtij subjekti politik ia kanë bërë të qartë se nuk do të përfshihen në përbërjen e kësaj qeverie

## Liderët shtetërorë: Sfidë për këtë vit, dialogu me Serbinë

Drejtesit e institucioneve të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë me dije se vazhdimi i dialogut me Serbinë, përkatësisht arritja e marrëveshjes paqësore ndërmjet dy vendeve, do të jetë sfida kryesore për vitin 2019. Sipas tyre, edhe në Kosovë edhe në Serbi janë shtuar zërat dhe e kanë kuptuar se një marrëveshje në mes të këtyre dy vendeve është e pashmangshme dhe në interes të dy popujve për të ecur përpara IFAQE 3



Ministria e  
Infrastrukturës:  
Të gjitha rrugët  
e vendit janë të  
kalueshme për  
qarkullim



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Kocijançiqi: Ekipi i Prishtinës është ftuar për konsultime ne Bruksel

BRUKSEL, 3 JANAR - Zëdhënësja e Bashkimit Evropian (BE), Maja Kocijançiq ka konfirmuar takimin me ekipit të ri të Prishtinës për dialog me Serbinë.

Zëdhënësja e Bashkimit Evropian (BE), Maja Kocijançiq ka thënë se më 8 janar në Bruksel do të zhvillohet një takim mes përfaqësuesve të Shërbimit Diplomatik

Evropian (EEAS) dhe ekipit të ri të Prishtinës për dialog me Serbinë. "Shërbimi Diplomatik Evropian për punë të jashtme ka ftuar ekipin dialogues të Kosovës për

konsultime më 8 janar", deklaroi ajo për mediet serbe. "Thirja ka ardhur pas themelimit të atij ekipi nga Parlamenti i Kosovës", shtoi Kocijançiqi.



## Nis punën Kongresi i ri i ShBA-së

Pas dy vjetësh kontrolli nga republikanët të Shtëpisë së Bardhë, Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve, demokratët të enjten morën kontrollin e kësaj të fundit, si rezultat i zgjedhjeve për Kongresin të mbajtura në muajin nëntor, gjatë të cilave demokratët siguruan në fund të procesit 235 vende në Dhomën e Përfaqësuesve prej 435 vendesh



ra për një vend në Kongres. Deb Haaland e New Mexico-s dhe Sharice Davids nga Kansasi janë dy gratë e para që përfaqësojnë në Kongres popullsinë indigjene të Amerikës. Gjithashtu Kongresi i ri ka edhe 10 ligjvënës që janë deklaruar hapur se i takojnë komunitetit LGBTQ.

Në total gratë mbajnë 102 vende në Dhomën e Përfaqësuesve dhe 25 vende në Senat.

Kongresi i ri përballet me sfidën e menjëhershme të trajtimit të çështjes së mbylljes së pjeshme të qeverisë. Deri tani ka pak gjasa që udhëheqësit demokratë të Dhomës së Përfaqësuesve dhe ata republikanë të Senatit, të bien dakord për një plan shpenzimesh që do të rihapte një të katërtën e shërbimeve qeveritare që aktualisht janë të mbyllura.

WASHINGTON, 3 JANAR - Kongresi i ri amerikan të enjten ka bërë betimin.

Pas dy vjetësh kontrolli nga republikanët të Shtëpisë së Bardhë, Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve, demokratët të enjten morën kontrollin e kësaj të fundit.

Kjo si rezultat i zgjedhjeve për Kongresin të mbajtura në muajin nëntor, gjatë të cilave demokratët siguruan në fund të procesit 235 vende në Dhomën e

Përfaqësuesve prej 435 vendesh. Republikanët morën dy vende më shumë në Senat dhe aktualisht gëzojnë një shumicë prej 53 vendesh në raport me demokratët që kanë 47.

Ligjvënësja Nancy Pelosi pritet të votohet si kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve, post të cilin ajo e ka mbajtur nga viti 2007 deri në 2011.

Disa demokratë kanë shprehur dëshirën për një drejtim të ri dhe Pelosi ka rënë dakord të shërbejë

jo më shumë se katër vjet si kryetare në këmbim të mbështetjes për këtë mandat. Kongresi i ri është më i larmishmi për nga përbërja në historinë e vendit.

Ai përfshin ligjvënës

Alexandria Ocasio-Cortez nga Nju Jorku, gruaja më e re e zgjedhur ndonjëherë në historinë e Kongresit. Po kështu Rashida Tlaib e Miçiganit dhe Ilhan Omar e Minesotës, janë dy gratë e para të besimit mysliman të zgjedhu-

## Stoltenbergu: Vendimi për ushtrinë u mor në kohë të gabuar

BRUKSEL, 3 JANAR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përsëriti se vendimi për transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në Ushtri është bërë në kohë të gabuar.

"Edhe pse në thelb çështja e transformimit të Forcave të Sigurisë është çështje në të cilën Kosova duhet të vendosë, ne e kemi bërë të qartë se ky veprim, po bëhet në kohë të gabuar. NATO-ja mbështet zhvillimin e Forcave të Sigurisë në kuadër të mandatit aktual. Me ndryshimin e mandatit, NATO-ja duhet të shqyrtojë nivelin e angazhimit të saj me Forcën e Sigurisë së Kosovës", ka thënë Stoltenberg. Ai më tutje theksoi se "të gjitha palët duhet të sigurojnë se ky vendim, që është marrë në kohë të gabuar, nuk do t'i rrisë tensionet në rajon dhe se të gjithë akterët politikë të



rajonit duhet të fokusohen në përparimin e reformave dhe dialogut".

Stoltenbergu tha se për diskutimet që po zhvillohen brenda NATO-s, i ka informuar presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrin e Kosovës, Ramush

Haradinaj.

"Kam theksuar se është e rëndësishme të ruhet qetësia dhe të ketë përmbajtje nga deklaratat që çojnë në eskalim të situatës", tha Stoltenbergu.

Ai tha se NATO-ja në mënyrë të plotë e përkrah procesin e normalizimit të raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, në kuadër të dialogut që zhvillohet në Bruksel duke e vlerësuar atë si "proces kyç për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit".

## Opozita jashtë Parlamentit

Tiranë, 3 janar - Prania e opozitës në dy seancat plenare të fund dhjetorit për të përfaquar kauzën e studentëve apo për të mbështetur nismën e saj për vettingun në politikë nuk ishte rikthim i saj në jetën parlamentare.

Ndonëse nuk ka ende një vendim të aleatëve dhe grupit të demokratëve për marrëdhëniet me Kuvendin apo Qeverinë, burimet pranë selisë blu thanë se opozita do t'i vazhdojë marrëdhënien e kushtëzuar edhe në sesionin e ri parlamentar që nis javën e tretë të janarit, siç kishte paralajmëruar Lulzim Basha.

Ishin jo të paktë ata që e panë praninë në Parlament pas 6 muajsh bojkot si lëvizje për të shpëtuar mandatet e deputetëve.

2019-a nuk pritet të sjellë ndryshime. Pavarësisht thirrjeve të ndërkombë-



tarëve për dialog në Parlament, mënyra se si u mbyll 2018-a në nuk paralajmëron zhvillime të reja.

Me një opozitë jashtë Parlamentit, me një reformë zgjedhore gati në të dështuar, shanset e një normaliteti politik zerohen. Ndërsa tensioni mund të rritet teksa politika do të jetë e fokusuar 6 muajt e parë të vitit tek zgjedhjet lokale që do të mbahen në muajin qershor.

## Zaevi optimist për votimin e ndryshimeve kushtetuese

SHKUP, 3 JANAR - Kryeministri maqedonas, Zoran Zaev nuk mund të konfirmojë nëse ka siguruar shumicë prej dy të tretash për votimin e fazës finale të ndryshimeve kushtetuese. Seanca kuvendore e caktuar për 9 janar nuk do të zgjasë dhjetë ditë siç parashikohet, pasi

VMRO-DPMNE-ja opozitare nuk do të marrë pjesë në debat. Zaevi megjithatë është optimist se procesi do të arrijë në finale.

"Do të bëj gjithçka deri në momentin e fundit, për të siguruar shumicën e dy të tretave dhe këtë do t'ia njoftojmë publikut në

momentin e votimit, ose do ta ndajmë kënaqësinë, ose do të marrim përsipër përgjegjësinë e gjithë këtij fokusi që e dhamë në integrimin. Por, edhe një herë përmend se jam optimist", tha Zoran Zaev.

Ai konfirmoi se sot (e premte) do të

takohet me Bilal Kasamin për të shqyrtuar kërkesat e BE-së që i shtrori si kusht me qëllim që partia e tij t'i votojë ndryshimet kushtetuese. Zaevi thotë se e sheh anën pozitive të situatës dhe se partitë opozitare shqiptare janë mbështetës të rugës evropiane të Maqedonisë.





# Liderët shtetërorë: Sfidë për këtë vit, dialogu me Serbinë

Drejtimesit e institucioneve të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë bërë me dije se vazhdimi i dialogut me Serbinë, përkatësisht arritja e marrëveshjes paqësore ndërmjet dy vendeve, do të jetë sfida kryesore për vitin 2019. Sipas tyre, edhe në Kosovë edhe në Serbi janë shtuar zërat dhe e kanë kuptuar se një marrëveshje në mes të këtyre dy vendeve është e pashmangshme dhe është në interes të dy popujve për të ecur përpara



**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 3 JANAR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se ambicia kryesore e Kosovës për këtë vit është dialogu me Serbinë, përkatësisht arritja e një marrëveshjeje paqësore, gjithëpërfshirëse, përfundimtare, që do ta sjellë njohjen e Kosovës nga Serbia dhe anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara. "Sfida, në të njëjtën kohë edhe mundësia kryesore për këtë vit, është arritja e marrëveshjes paqësore me Serbinë. Kjo pastaj do të na mundësonte që t'u kthehemi sfidave dhe nevojave të tjera që kemi, që nga përmbyllja e konsolidimit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës deri te thellimi i reformave në shtet dhe në shoqëri, forcimi i mëtutjeshëm i sundimit të ligjit dhe zhvillimi ekonomik i vendit. Kosova është shtet i potencialeve të pashfrytëzuara, prandaj edhe sfidat që kemi përpara duhet t'i shohim më shumë si mundësi sesa si sfidë apo pengesë", ka deklaruar Thaçi në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re".

Thaçi ka treguar se ende nuk ka kontura të marrëveshjes dhe, sipas tij, do të jetë delegacioni shtetëror për dialogun që do të negociojë deri në detaje marrëveshjen. "Por, ajo që dihet është se çfarë kërkon Kosova nga ky proces dhe kjo është njohja reciproke me Serbinë dhe ulësja për Kosovën në Kombet e Bashkuara", është shprehur ai, duke shtuar se marrëveshja synon të sjellë paqe dhe stabilitet të përherëshëm në Kosovë dhe në rajon.

"Çfarëdo formule tjetër që cenon shtetësinë dhe stabilitetin e shtetit të Kosovës, si ajo për një bashkësi të komunave serbe me kompetenca ekzekutive, nuk është zgjidhje në interes të Kosovës apo të paqes në rajon", ka theksuar Thaçi. Sipas tij, dështimi për arritjen e kësaj marrëveshjeje do të jetë kthim prapa. "Marrëveshja duhet të jetë e atillë që të gjitha palët të ndihen fitimtare nga ky proces, pra jo vetëm Kosova, por edhe Serbia si dhe bashkësia ndërkombëtare. Unë kam kërkuar që në këtë proces të përfshihet edhe Lugina e Preshevës dhe të kërkohet që Presheva, Medvegja dhe Bujanoci t'i bashkohen Kosovës", ka deklaruar Thaçi. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, e ka ftuar spektrin politik të flasë me një zë për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se në këtë proces partitë duhet të përballen me Serbinë e jo me njëra-tjetrën. Veseli ka bërë me dije se në këtë proces Kosova synon të ketë një marrëveshje me Serbinë, e cila, sipas tij, nuk është as më shumë e as më pak sesa Kosova shtet i pavarur dhe sovran dhe që me territorin e saj të njihet nga shteti i Serbisë dhe do ta fitojë ulësen në OKB. "Ne të gjithë duhet të marrim përgjegjësi. Me vetë faktin se në këtë proces përballë do ta kemi Serbinë, ne nuk duhet ta kemi përballë njëri-tjetritin. Spektri politik duhet të jetë unik kur bëhet fjalë për interesat kombëtare të Kosovës sepse çdo formë tjetër e veprimit është kundër interesit të Kosovës", ka thënë Veseli në

një intervistë për gazetën "Epoka e re". Ndërsa kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vlerësuar se ky vit nuk do të jetë i lehtë për Kosovën për shkak të sfidës së dialogut me Serbinë dhe Gjykatës Speciale. Por ai ka thënë se askush nuk duhet të frikësohet nga faza finale e dialogut me Serbinë. Sipas Haradinajt, as deputetët e AAK-së nuk do ta votojnë në Kuvend një marrëveshje të keqe për vendin. Ai ka theksuar se do të ishte mirë që gjatë këtij viti Kosova të arrinte marrëveshjen me Serbinë. "Do të ishte më mirë që këtë vit në të cilin po hyjmë ta shfrytëzojmë për t'i kryer disa punë që kanë mbetur pa u kryer. Do të ishte mirë që ta përmbyllim sovranitetin tonë të brendshëm dhe ta mbyllim marrëveshjen me Serbinë e cila ka mbetur hapur, e cila do ta na sillte njohjen nga Serbia dhe ulësen në OKB", ka deklaruar Haradinaj në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re". Ndërsa lideri i Nismës Socialdemokrate dhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se Kosova ka arritur ta bëjë hapin e madh drejt unifikimit dhe unitetit për procesin e dialogut. Sipas tij, kthimi i dialogut në Kuvend është hap drejt unifikimit të faktorit politik të Kosovës për zgjidhjen e problemit me Serbinë. "Besoj se edhe në Kosovë edhe në Serbi janë shtuar zërat dhe e kanë kuptuar se një marrëveshje në mes të këtyre dy vendeve është e pashmangshme dhe është në interes të dy popujve për të ecur përpara. A do të arrihet marrëveshja në vitin 2019 apo jo varet nga shumë faktorë. Por, një gjë e di sigurt, se ajo marrëveshje do të ndodhë. Më mirë të ndodhë sa më shpejt për të dyja vendet e të humbim më pak sesa të vonohet dhe të kemi dëme më të mëdha të dy popujt. Është në interesin e të dy vendeve tona që sa më shpejt të arrihet marrëveshja dhe ta përmbyllim njëherë e mirë të

kaluarën tonë tragjike dhe t'i identifikojmë interesat për rrugëtimin tonë të përbashkët drejt integritimit euroatlantike", ka thënë Limaj në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re".

Ai ka bërë me dije se delegacioni i Kosovës nuk mund të lejojë pushtet të tretë apo një lloj 'republika serbe' sepse kjo do të thotë çmontim i shtetit të Kosovës. "I sigurojmë qytetarët e Kosovës, se ekipi negociator do të punojë fort për një marrëveshje me vlera evropiane, një marrëveshje e cila përmbyll konfliktet dhe nuk lë asnjë shkak për konflikte të ardhshme. Duam një marrëveshje e cila krijon paqe dhe jo një marrëveshje e cila mund të lë situata që mund të kthehen në konflikte. Prandaj Kosova është kundër ndarjes dhe çfarëdo pushteti të tretë. Jemi kundër ndarjes së vendit tonë, po punojmë me Kushtetutën e Kosovës, Deklaratën e Pavarësisë dhe me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë", është shprehur Limaj.

## Mërgimtari Agim Paçarizi ndihmon institucionet arsimore në Malishevë

**MALISHEVË, 3 JANAR** - Mërgimtari nga Dragobili, Agim Paçarizi, në bashkëpunim me shoqatat kulturore dhe mërgimtarë nga Kosova, dhe me ndihmën e Universitetit të Friburgut, ka dhu-

ruar për institucionet arsimore të Komunës së Malishevës, 93 kompjuterë të kompletuar dhe 29 kompjuterë vetëm shtëpiza, tastiera dhe mausa, me qëllimin e vetëm për t'i ndihmuar nxënësit,

mësimdhënësit që të arrijnë mësimdhënie dhe mësimnxënie më të suksesshme. Nën kryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe

Edukim, Blerim Thaqi, kanë falënderuar mërgimtarin Paçarizi, shoqatat, mërgimtarët nga Kosova, si dhe Universitetin e Friburgut për këtë donacion dhuruar nxënësve të Malishevës.





Flet për "Epokën e re", Ramush Haradinaj

# Zgjedhjet e parakohshme nuk

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme në këtë vit nuk është në interes të vendit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se viti 2019 nuk do të jetë i lehtë për Kosovën pasi do të përballet me procesin e dialogut me Serbinë dhe Gjykatën Speciale. Haradinaj ka ftuar dy subjektet më të mëdha opozitare, LDK-në dhe Lëvizjen Vetëvendosje, që të bashkohen në procesin e dialogut, duke thënë se askush nuk duhet të frikësohet nga ky proces. Kryeministri ka folur edhe për raportet që Qeveria ka krijuar me PSD-në. Sipas tij, zyrtarët e këtij subjekti politik ia kanë bërë të qartë se nuk do të përfshihen në përbërjen e kësaj qeverie

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 3 JANAR** - Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se nuk është në interes të vendit mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme në vitin 2019. Ai ka thënë se në këtë vit është më e rëndësishme për Kosovën t'i mbyllë disa procese të rëndësishme sesa të shkojë në zgjedhje të reja. Në pjesën e dytë të intervistës dhënë për gazetën "Epoka e re" për numrin festiv, kryeministri ka thënë se partia të cilën e udhëheq, AAK-ja, kurrë nuk ka qenë më e fortë për zgjedhje të reja. "Si Aleancë besoj se kurrë punët më mirë për zgjedhje nuk i kemi pasur, por nuk e di sa është në interes të vendit shkuarja në zgjedhje të reja në proceset që është Kosova", ka thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se ky vit nuk do të jetë i lehtë për Kosovën për shkak të sfidës së dialogut me Serbinë dhe Gjykatës Speciale. Kryeministri i vendit ka vlerësuar se askush nuk duhet të frikësohet nga faza finale e dialogut me Serbinë. Ai ia ka bërë të qartë edhe opozitës se as deputetët e AAK-së nuk do ta votojnë në Kuvend një marrëveshje të keqe për vendin. Haradinaj në këtë intervistë ka folur edhe për raportet e

Qeverisë me subjektin opozitar PSD-në. Ai ka treguar se do të kishte dëshirë ta përfshinte këtë subjekt politik në Qeveri por, sipas tij, zyrtarët e PSD-së ia kanë bërë të qartë se në këtë mandat nuk do të përfshihen në Qeveri.

**"Epoka e re": Z. Haradinaj, së fundi Qeveria ka krijuar një raport interesant me subjektin opozitar, PSD-në. Si do ta definoni këtë raport të PSD-së me Qeverinë?**

Haradinaj: Moti kam një miqësi me z. Ahmeti, z. Ymeri, z. Molliqaj dhe kolegë të tjerë të PSD-së, pra që nga koha kur ishim në VLAN, kur bashkëpunonim si opozitë. Që nga ajo kohë ne kemi komunikuar për shumë tema. Kur e mora qeverisjen, e vizitova kryetarin e Prishtinës dhe e bëmë një listë të temave dhe të punëve që ai kishte nevojë për kryeqytetin. Dhe pastaj, kur e vizitova, pas gati një viti përsëri Komunën e Prishtinës, shkova me listën që i kisha përfunduar të gjitha obligimet që kisha marrë si kryeministër. Natyrisht se ai ishte në një pozicion jo të mirë si opozitë dhe deklaroi se me pas mundësi do ta rrezonte Qeverinë. Sa iu përket temave për kryeqytetin, ai e pranoi se të gjitha i kemi kryer. Pastaj, kjo

marrëdhënie evuloi edhe me largimin e Listës Serbe nga koalicioni qeverisës, për të cilën kam respekt sepse kemi punuar shumë mirë me të, mirëpo dihet se unë i shërbej agjendës së Kosovës dhe më vjen keq që në raste të caktuara Lista Serbe është keqpërdorur nga Beogradi zyrtar. Me largimin e Listës Serbe, PSD-ja ia mundësoi Kosovës që Qeveria e saj t'i ketë duart e lira për marrjen e disa vendimeve të drejta, si rasti për ushtrinë. Pa përkrahjen e tyre ne nuk e kishim përkrahjen në Kuvend, pastaj përkrahjen për ushtrinë e dhanë edhe LDK-ja dhe LV-ja. Megjithatë, roli i PSD-së është më i drejtpërdrejtë dhe më paraprak, sepse qysh në fillim na ka përkrahur për të ardhur deri te dita kur të votohet. PSD-ja e ka një kontribut në disa tema të interesit kombëtar për të cilat e respektoj shumë. Ata që i ndihmojnë atdheut, edhe nëse janë kundërshtarë të mi, unë i respektoj.

**"Epoka e re": A mund të përfshihet ky subjekt politik në qeverinë tuaj?**

Haradinaj: Do ta mirëprisja në çdo kohë që të bëhet pjesë e Qeverisë, sepse ka kuadër të mirë dhe njerëz profesionistë.

**"Epoka e re": Si do t'ia gjenit**



**vendin këtij subjekti në qeveri?**

Haradinaj: Do të ishte gjetur një formulë. Me të gjithë partnerët do t'ia kishim krijuar një hapësirë. Pra, të gjithë partnerët kishin dhënë diçka prej hapësirës së vet në Qeveri për një partner si PSD-ja.

**"Epoka e re": Në takimet që keni pasur me zyrtarët e PSD-së, a kanë shprehur ndonjë gatishmëri që të bëhen pjesë e Qeverisë?**

Haradinaj: E di se në opinion gjithë mendojnë se ekziston një farë dashurie e fshehtë për pushtet. Mirëpo, sa kam komunikuar me ta, ata kanë thënë se duan që t'ia mundësojnë Kosovës t'i kryejë ato punë që mundet, pra duke mos e bllokuar vendin. Ata nuk janë të interesuar të marrin përgjegjësi qeverisëse në konstelacionin e tanishëm qeverisës. Ata më kanë thënë se nëse ti kryen një punë që është në interes të Kosovës, e ke përkrahjen tonë. Më vjen shumë mirë që PSD-ja gjeti guximin në këtë drejtim.


**"Epoka e re": Një mbështetje e tillë, a ju bën të ndiheni më komod në postin e kryeministrit?**

Haradinaj: Mendoj se pozicioni i

PSD-së, se nuk e bashkon votën me Listën Serbe për ta rrëzuar Qeverinë, është gati i pritshëm. Nuk duhet askush të befashohet që në kohën kur kjo Qeveri po kryen punë për vendin, si rasti i ushtrisë dhe i taksës 100 për qind, të dalë dikush nga opozita ta rrëzojë Qeverinë në këtë kohë. Nuk mundesh t'ia marrësh inatit kësaj qeverie që po kryen punë të brezave. Themelimi i ushtrisë ka qenë punë e brezave. Ne me breza e kemi pritur këtë ditë që ta kemi ushtrinë tonë.

**"Epoka e re": Me ndihmën e PSD-së Kuvendi ka arritur ta marrë një vendim për dialogun me Serbinë, duke e miratuar rezolutën për këtë proces. Sa sfiduese do të jetë kjo fazë e dialogut për Qeverinë që drejtoni?**

Haradinaj: Qeveria i ka ofruar ekipit negociues çdo gjë që ka, duke përfshirë edhe njerëzit, vetëm që ta kemi transparent këtë proces. Kjo është një situatë që na jep më shumë garanci se nuk do të befashohemi. Të gjitha materialet ua ka dërguar edhe deputetëve opozitarë të LDK-së dhe të LV-së. E kam bërë këtë, sepse një ditë për çdo marrëveshje me Serbinë do të kërkohen dy të tretat e votave për ratifikim. Në disa raste transparenca me kohë





# janë në interes të vendit



është më e vështirë, sepse jep hapësirë për kritikë, mirëpo e mira është se deputeti e përcjell materien dhe ai në fund nuk është i befusuar. Neve në të kaluarën na kanë sjellë marrëveshjen në seancë, të cilën më herët kurrë nuk e kemi parë. Kështu ka ndodhur me marrëveshjen e asociacionit dhe atë të demarkacionit me Malin e Zi. Më mirë do të ishte që edhe LDK-ja dhe LV-ja të ulen në delegacion dhe në fund, nëse marrëveshja është e keqe, t'i thonë jo. Edhe deputetët e Aleancës do t'i thonë jo një marrëveshje të keqe, sikurse do t'i thonë jo edhe deputetët e PDK-së dhe të Nismës. Duhet ta kemi parasysh se Amerika është shumë e qartë me ne. Edhe letra e presidentit Trump flet shumë hapur, kur thotë se e përkrahin suksesin e Kosovës si shtet i

pavarur dhe sovran. Nëse Trumpi po e thotë këtë, atëherë pse po frikësohen? Ejani uluni në tavolinë.

**"Epoka e re":** A ka legjitimitet ky ekip negociator, meqenëse nuk po i bashkohen dy subjektet qeveritare?

**Haradinaj:** Ky ekip përbëhet nga disa parti të koalicionit qeverisës dhe një parti opozitare. Janë parti shqiptare dhe të minoritetëve. Pra janë njerëz të zgjedhur. Kur është votuar për ekipin negociator në sallë kanë qenë 61 deputetë. Ky ekip ka legjitimitet politik dhe kushtetues. Vendimi i Kuvendit të Kosovës është legjitim dhe legal.

**"Epoka e re":** Pse nuk po iu bashkohen LDK-ja dhe LV-ja?

**Haradinaj:** LDK-ja është mirë të

vijë në tavolinë. Pra mund të vijë t'i marrë materialet dhe pastaj të shkojë t'i diskutojë ato me strukturat e partisë dhe në fund le të votojë. Nuk ka rrezik të ndodhë diçka që do t'i mbesë në derë, pra ndonjë e keqe. Mosardhja në tavolinë është frikë, është ikje prej përgjegjësisë. Vetëvendosja ka një pozicion tjetër, por edhe ajo si vëzhguese ka mundësi të vijë.

**"Epoka e re":** Megjithatë, ekziston një lloj frike se në këtë proces Kosova do të bëjë një kompromis të dhimbshëm. Si kryeministër i vendit, a mund t'i garantoni qytetarët se nuk do t'i ndodhë asgjë e keqe Kosovës në këtë fazë të dialogut?

**Haradinaj:** Për këtë arsye ne kemi marrë iniciativën dhe kemi shkruar librin e madh, në të cilin

kemi paraqitur ofertën tonë dhe në të cilin kemi treguar se çka dëshirojmë. Ky libër i ka 16 kapituj. Po vazhdojmë t'i shkruajmë ende kapitujt. Për mua është e pakuptimtë frika për këtë proces. Ne duhet të kemi pak vetëbesim, sepse deri këtu ne nuk kemi ardhur duke u frikësuar, por duke i kërkuar të drejtat tona. Ne kemi mundur të kemi pasur frikë edhe për formimin e ushtrisë dhe nuk do ta kishim formuar fare. Mund të kemi frikë nga një marrëveshje, por duhet ta bëjmë edhe atë marrëveshje. Duhet t'i kryejmë punët me fqinjën tonë verior.

**"Epoka e re":** Jeni të bindur se nuk do të ketë ndarje në këtë proces?

**Haradinaj:** Letra e presidentit Trump thotë se e përkrahim

suksesin e Kosovës së pavarur dhe sovran. Nëse ne si vend sovran çmendemi dhe duam ta japim tokën tonë, atëherë është diçka tjetër. Nëse ne jemi njerëz normalë, dhe besoj se jemi, Kuvendi i Kosovës nuk e voton një opsion të tillë. Duke qenë pjesë e tavolinës në dialog nuk ka rrezik që procesi të dalë nga kontrolli. Rrezik do të ishte sikur në emër të Kosovës të shkonte në bisedime vetëm një njeri.

**"Epoka e re":** Kur prisni që të arrihet kjo marrëveshje?

**Haradinaj:** Nuk e di. Neve na intereson të kemi një dialog përmbytësor, jo vetëm takime sa për të bërë fotografi. Ndoshta do të duhej një dialog si i Dejtonit apo i Rambujesë, ku do të mbylleshin punët.

**"Epoka e re":** Opozita po pretendon se viti 2019 do të jetë vit i zgjedhjeve të parakohshme?

**Haradinaj:** Si Aleancë besoj se kurrë punët më mirë për zgjedhje nuk i kemi pasur, por nuk e di sa është në interes të vendit shkuarja në zgjedhje të reja në proceset që është Kosova. Asnjëherë nuk do t'i kërkoj zgjedhjet për interes të Aleancës. Ne jemi të gatshëm për këtë proces nëse dikush e vlerëson atë si hap të duhur. Do të ishte më mirë që këtë vit ta shfrytëzojmë për përfundimin e disa punëve që kanë mbetur pa u kryer. Do të ishte mirë që ta përmbyllim sovranitetin tonë të brendshëm dhe ta mbyllim marrëveshjen me Serbinë e cila ka mbetur hapur dhe e cila do ta na sillte njohjen nga Serbia dhe ulësen në OKB. Viti 2019 do të jetë një vit i rëndësishëm, sepse do të jenë edhe implikimet e Gjykatës Speciale. Mirëpo qëllimi im është, ta ruajmë Kosovën. Nuk do të kërkoj zgjedhje. Do të kërkoj vetëm konsolidimin e Kosovës. Po ashtu, jam i interesuar t'i ruaj ish-pjesëtarët e UÇK-së, pra t'i përkrah të gjitha ata që përballeshin me këtë sfidë. Ne duhet ta nderojmë veten edhe para drejtësisë, duke mos u turpëruar. Nuk duhet të ndodhë që ndonjë ish-pjesëtar i UÇK-së të bëjë ndonjë veprim të pahijshëm dhe të pandershëm për Kosovën.

## Mbetet në fuqi edhe për dy muaj paraburgimi për tre të dyshuarit për vrasjen e Ivanoviqit

**MITROVICË, 3 JANAR** - Gjykata e Apelit i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës kundër vazhdimin të masës së paraburgimit prej dy muajsh për të pandehurit Nedeljko Spasojeviq, Dragisha Markoviq

e Marko Rosiq. Në këtë mënyrë Apeli ka lënë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 21. 12. 2018, sipas të cilit, kjo masë do të zgjasë deri më 23. 2. 2019. Sipas prokurorisë, Nedeljko Spasojeviq dhe

Marko Rosiq dyshohen se si pjesë e një grupi kriminal kanë kryer veprën e ndihmës në vrasje të rëndë.

Ndërsa i pandehuri Dragisha Markoviq, po ashtu si anëtar i grupit, dyshohet të ketë kryer veprën penale të zbulimit të

fshehtësisë zyrtare, sipas nenit 433 të po të këtij kodi. Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi bazën ligjore për të cilën ka caktuar masën e paraburgimit ndaj tij.





# Viti 2019, viti i vendimit historik



**Shkruan: Hashim THAÇI**

Kthesat e mëdha historike, të cilat e kanë vendosur fatin e shteteve dhe popujve anekënd botës, shpesh kanë qenë rezultat qoftë edhe i një vendimi të vetëm. Kështu ka ndodhur edhe me ne. Historia e popullit tonë është e përcaktuar nga momente të ndritshme, kur ne kemi marrë vendime të drejta, por edhe të mençura në momente të duhura, të cilat janë përkrahur nga shtetet e fuqishme. Nuk do të ishim të sinqertë me vetveten nëse mendojmë se nuk ka pasur raste kur kemi humbur mundësi historike për shkak të mungesës së vendimmarrjes ose vendimeve të gabuara.

Një moment i tillë përcaktues apo vendimtar yni, i cili duhet të ndodhë në të ardhmen e afërt, ndërlihet me marrëveshjen përfundimtare për normalizim të plotë të marrëdhënieve me Serbinë. Mendoj se nuk ka moment më të mirë se tani për të arritur paqen e qëndrueshme dhe përfundimtare. Rrethanat politike në Kosovë dhe Serbi mundësojnë një marrëveshje të tillë. Ndërkaq, në favor të shfrytëzimit të plotë të kësaj mundësie historike janë ShBA-ja dhe BE-ja. Nuk kemi kohë për të humbur tani, por me zgjuarsi dhe të bashkuar duhet të vendosim për të mbyllur konfliktin shekullor me Serbinë dhe për ta hapur atë të paqes. Historia, koha dhe gjeneratat e ardhshme do të na gjykojnë për veprimin e duhur apo humbjen e mundësisë. Unë dua që të mbahemi në mend për të parën.

## Një letër, një kuptim

Letra e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, pritshëm bëri bujë të madhe në Kosovë. Nuk ka si të ishte më e drejtpërdrejtë dhe të mos linte aspak hapësirë për keqinterpretim. Amerikanët nuk

është se janë të njohur për qasje dykuptimshme, aq më pak presidenti aktual i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai është i drejtpërdrejtë dhe mesazhi i tij drejtuar Kosovës nuk ka si të jetë më i qartë. Por, asnjëherë nuk bën t'i nënvlerësojmë tendencat tona për t'i interpretuar gjërat ashtu siç i përshtaten agjendës sonë personale, grupore ose partiake. Jetojmë në një botë, ku secili është i lirë t'i kuptojë e keqkuptojë gjërat ashtu siç ia do qejfi, dhe pa asnjë përgjegjësi t'i paketojë ato për publikun e gjerë. Por, e vërteta është një.

Letra e presidentit Trump ka vetëm një kuptim krejt të qartë. Dhe është tejet e rëndësishme që opinioni ynë publik të mos i devijojë porositë që na dërgoi shteti më i fuqishëm në botë, aleati kryesor i vendit tonë.

Përmbajtja e letrës së presidentit të ShBA-së, Donald Trump, kishte dy qëllime thelbësore. Së pari, ishte një thirrje dhe inkurajim për të gjithë liderët e Kosovës, për të shfrytëzuar momentumin e krijuar dhe për të bërë marrëveshje gjithëpërfshirëse të paqes me Serbinë. Gjithashtu, i vetëdijshëm për polarizimet ekzistuese, të cilat janë të rrezikshme, presidenti Trump na bëri thirrje edhe që të jemi të bashkuar dhe të flasim njëzëri për marrëveshjen.

Ndërsa, mesazhi i dytë thelbësor, ndërlihet me kuptimin e seriozitetit të situatës dhe të shfrytëzimit të mundësisë unike për të arritur marrëveshjen. Presidenti Trump e bëri të qartë se dështimi ynë eventual për të arritur marrëveshjen mund të ketë pasoja tragjike, jo vetëm për Kosovën, por edhe më gjerë. Prandaj, edhe na tërheq vërejtjen që ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe të përmbahemi nga vendimet, të cilat mund ta vështirësojnë edhe më shumë arritjen e një marrëveshjeje paqësore.

## Vendimi është yni

Ne jemi të bekuar që kemi aleatë të fuqishëm në botë. Mbi të gjitha, që kemi mbështetjen e ShBA-së. Këtë vit shënuam dhjetëvjetorin e pavarësisë së shtetit tonë. Të gjithë kanë pritur nga ne, si liderë dhe nga institu-

cionet tona shtetërore, që të sillemi më ndryshe. Të dëshmojmë se kemi pjekuri dhe maturi të mjaftueshme politike për ta mbajtur Kosovën në drejtimin e duhur, atë drejt integriteteve euroatlantike. Kanë pritur që mos të jemi kaq të përçarë me njëri-tjetrin në çështje të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlihen me interesin tonë shtetëror. Por, ne i kemi zhgënjyer shpeshherë miqtë tanë ndërkombëtarë. Prandaj, ata edhe dhjetë vjet pas krijimit të shtetit tonë, detyrohen të na japin këshillat e tyre më të mira.

Do të ishte mirë për vetë ne që të gjenim urtësinë dhe guximin, që një herë të marrim një vendim të guximshëm, të mençur dhe në kohën e duhur. Për më tepër, ne edhe kësaj radhe kemi përkrahje për këtë vendim nga aleatët tanë, të cilët e kemi për obligim t'i respektojmë. Prandaj, nuk ka vend për frikë dhe hamendje. Të kujtojmë episodin e fundit të dështimit tonë. Përkundër këshillave dhe insistimit të partnerëve tanë ndërkombëtarë për ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi në vitin 2016, si kusht i vetëm për liberalizimin e vizave, ne dështuam ta bëjmë një gjë të tillë. Për më keq, Kosova papritmas u shndërrua në arenë të protestave të dhunshme. Kështu, me lehtësinë më të madhe dhe falë kauzave të rrejshme politike, humbëm momentumin dhe ia pamundësuaam BE-së që ta marrë vendimin për heqjen e vizave.

Në fund, u deshën dy vite debate monotone dhe shterpe për këtë çështje, që e njëjta marrëveshje të ratifikohet nga Kuvendi i Kosovës. Çfarë fitoj Kosovë nga e gjithë kjo? Asgjë, përveç vazhdimit të izolimit. Prandaj, unë shpresoj se liderët e vendit në vitin 2019 do të jenë të gatshëm, që pa hezitim të marrin vendime të vështira, por të domosdoshme, për interesin shtetëror dhe paqen në Ballkan e më gjerë. Nga ana ime, dua t'i siguroj qytetarët se nuk do të ngurroj për asnjë moment që të marrë vendime në interes të shtetit tonë dhe në përputhje me këshillat miqësore të aleatëve tanë, respektivisht të ShBA-së.



## Pezullohet greva e mjekëve

PRISHTINË, 3 JANAR (ER) - Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në mbledhjen e Këshillit Drejtues të mbajtur të enjten ka vendosur që greva e mjekëve të pezullohet dhe t'i hapet rrugë dialogut social me Qeverinë sipas afateve të premtuara deri në miratim të Ligjit mbi Pagat. "Këshilli Drejtues vendos që Kryesia e Federatës ta monitorojë procesin e grupit negociator dhe, sipas rrjedhës, ta informojë Këshillin Drejtues të Federatës i cili do t'i ndër marrë hapat e mëtut-

jeshëm sindikalë. Për çdo manifestim (grevë, protestë) të organizuar jashtë vendimeve të Këshillit Drejtues të FSSHK-së nuk mbajmë përgjegjësi. FSSHK-ja distancohet përfundimisht nga grupet që organizojnë greva apo bojkote të punës, sepse jemi të vetëdijshëm që popullata ka nevojë për shërbime, ndërsa për realizimin e qëllimeve tona ne do ta ndjekim rrugën e dialogut social deri kur strukturat relevante vendimmarrëse nuk e cenojnë interesin e mantelbardhëve", është thënë në njoftimin e FSSHK-së.

## Aliu: 90 për qind e buxhetit është borxh për shkak të qeverisjes së kaluar

PRISHTINË, 3 JANAR (ER) - Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në mbledhjen e Këshillit Drejtues të mbajtur të enjten ka vendosur që greva e mjekëve të pezullohet dhe t'i hapet rrugë dialogut social me Qeverinë sipas afateve të premtuara deri në miratim të Ligjit mbi Pagat. "Këshilli Drejtues vendos që Kryesia e Federatës ta monitorojë procesin e grupit negociator dhe, sipas rrjedhës, ta informojë Këshillin Drejtues të Federatës i cili do t'i ndër marrë hapat e mëtutjeshëm sindikalë.

Për çdo manifestim (grevë, protestë) të organizuar jashtë vendimeve të Këshillit Drejtues të FSSHK-së nuk mbajmë përgjegjësi. FSSHK-ja distancohet përfundimisht nga grupet që organizojnë greva apo bojkote të punës, sepse jemi të vetëdijshëm që popullata ka nevojë për shërbime, ndërsa për realizimin e qëllimeve tona ne do ta ndjekim rrugën e dialogut social deri kur strukturat relevante vendimmarrëse nuk e cenojnë interesin e mantelbardhëve", është thënë në njoftimin e FSSHK-së.



## Rikthehen pritjet e gjata në Merdarë dhe te Dheu i Bardhë

MERDARË, 3 JANAR - Me rastin e festave të fundvitit janë krijuar kolona të gjata të pritjeve në pikat kufitare te Dheu i Bardhë dhe në Merdarë. Kolona e automjeteve në

pikëkalimin kufitar në Merdarë është 1 000 metra e gjatë në dalje. Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, qytetarët në këtë pikë

kufitare presin dy orë për të dalë nga territori i Kosovës, kurse ata që hyjnë në territorin tonë nuk presin më shumë se dhjetë minuta. Ndërkaq, tek pika tjetër

kufitare që lidh Kosovën me Serbinë, gjegjësisht te Dheu i Bardhë, kolona është 450 metra dhe për të dalë nga kjo pikë pritjet janë deri në 90 minuta.





# Fshati Akllap ka pasur 104 shtëpi, sot është gati i boshatisur

EPOKA  
ERE

Ismail REXHEPI

LIPJAN, 3 JANAR - Fshati Akllap është vendi më i thellë malor i Komunës së Lipjanit. Po të hyjë njeriu për herë të parë në këtë fshat, do të jetë i fascinuar me mrekullitë që ka ditur t'i krijojë vetëm Zoti. Aty shihet një peizazh që vështirë mund ta kenë fshatrat e tjerë. Një pjesë e Akllapit, nga malet e Zhegocit dhe të Janjevës, është e rrethuar me drurë të bukur, ndërsa të dyja anët e tjera janë me kullosa, që magjepsin me pamjen e tyre. Por, gjithë këtyre bukurive të rralla të natyrës, një numër jo i vogël i familjeve nuk ia ditën vlerën, pasi u shpërngulën nga fshati, e mendonin se diku në Lipjan do t'i presë "mrekullia". Disa i shitën si mundën pronat, ndërkaq të tjerët i lanë shtëpitë e boshatisura dhe arat djerrina. Akllapi është 17 kilometra nga qendra komunale e Lipjanit.

Fshati Akllap gjatë luftës që dje-gur thuaja tërësisht nga barbaria serbe, po ashtu patë edhe të vrarë e të plagosur. Fshati Akllap ka kushte ideale për të ushtruar shumë veprimtari bujqësore, në rend të parë është blegtoaria. Përderisa para luftës kishte familje që kishte 200 deri 300 dele, apo më mirë të themi i gjithë fshati i kishte mbi 2 000 dele, për çka edhe mori nofkën 'fshat i dhenve', sot as njëzet dele nuk mund t'i gjesh në gjithë fshatin.

Më parë Akllapi ka pasur 104 shtëpi, ky numër sot është përgjysmuar, edhe pse fshati ka rrugën e asfaltuar, shkollën fillore, dyqanin, ujë që të pikë në ballë nga të ftohtit, i cili vjen nga burimet e kodrave malore. Këtu toka punohet nga banorët që mbetën pa e lëshuar fshatin, ndërsa bujqit zakonisht kultivojnë kulturat bujqësore, si grurë dhe misër, mirëpo nuk mungojnë as kulturat e tjera, si patatat, lakrat, fasulja etj. Me



një fjalë, të gjitha kulturat kopshtare. Po ashtu, fshati Akllap njihet edhe për kultivimin e pemëve.

Fshati Akllap ka një histori të begatë kulturore e kombëtare, sepse këtu lindën e u rritën atdhetarë të shumtë, siç ishte Rexhep Akllapi, Jetish Akllapi. Ndërkaq, gjatë kohës sa gjendej

Kosova nën okupimin serb, në Akllap kanë gjetur vend për të zhvilluar veprimtari politike e kombëtare shumë figura të njohura kombëtare. Jo vetëm kaq. Akllapi ka edhe një histori tjetër të veçantë, sepse këtu gjendet një kishë eremite që mendohet se më parë ishte hyrje e minierës, por që u adaptua më

vonë si kishë. Hyrjet e tilla të çojnë deri në fshatin Vukoçincë dhe në Janjevën e lashtë. Këta pak banorë, që ende kanë mbetur në Akllap, u shprehën se një ditë jo të largët, pra nisur nga braktisja e fshatit që është duke ndodhur, ky fshat do të mbetet në kujtesën e njerëzve, se ishte një herë këtu një Akllap.

## Ministria e Infrastrukturës: Të gjitha rrugët e vendit janë të kalueshme për qarkullim

PRISHTINË, 3 JANAR (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar të enjten qytetarët se pas reshjeve të fundit të borës të gjitha rrugët në vend janë të kalueshme. "Kompanitë e mirëmbajtjes së rrugëve, të kontraktuara nga Ministria e Infrastrukturës, janë në kujdestari 24 orësh dhe deri më tani kanë arritur me sukses që rrugët e vendit t'i mbajnë të hapura dhe të sigurta për qarkullim. MI u bënë thirrje ngasësve t'u përshtaten kushteve të rrugëve dhe jenë të pajisur me pajisje dimërore konform ligjit, në mënyrë që të zhvillojnë qarkullim të sigurt



dhe pa pengesa", është thënë në një njoftim për media. Ministria e Infrastrukturës u ka

bërë thirrje disa prej mediave në vend, që të mos publikojnë lajme të paqena lidhur me

gjendjen e rrugëve në vend, duke shkaktuar panik dhe huti në mesin e qytetarëve. "Ministria e Infrastrukturës mbetet e përkushtuar që në vazhdimësi të sigurojë qarkullim të lirë dhe të sigurt në trafikun rrugor. Andaj, duke u kërkuar të gjithë ngasësve që të kenë kujdes gjatë vozitjes, apelojmë te qytetarët e vendit që për çdo pengesë në ato rrugë që janë përgjegjësi e ministrisë, të kontaktojnë pa hezitim, në mënyrë që të merren masa adekuate konform situatës", është theksuar në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

### Bora e madhe bllokoi rrugët në Brezovicë

Si pasojë e të reshurave të mëdha të borës disa vetura kanë mbetur të bllokuara nëpër rrugët e Brezovicës. Temperaturat gjatë natës së mërkurë kanë rënë në minus nëntë gradë, duke ngrirë rrugët dhe duke i bërë ato të pakalueshme për turistët.

## Zëvendëspresidenti i PE-së viziton xhaminë në Drenas, bën homazhe edhe në Prekaz

DRENAS, 3 JANAR - Zëvendëspresidenti i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, ka vizituar xhaminë e fshatit Zabel i Ulët i Komunës së Drenasit, ku është pritur nga kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Drenas, njëherësh edhe imam i xhamisë së fshatit Zabel i Ulët, Valon Bequku dhe kryesia e Bashkësisë Islame atje. Me këtë rast, Wieland ka përgëzuar qytetarët e Komunës së Drenasit për tolerancën fetare që kanë dhe ka thënë se për këtë ndihet i lumtur që është qytetar nderi i Komunës së Drenasit. "Drenasi shquhet për tolerancë fetare dhe për këtë përgëzoj gjithë komu-



nitetin e këtij vendi që tregon respekt ndaj njëri-tjetrit. Ndihej shumë mirë që i përkas titullit më të mirë të mundshëm, qytetar nderi i kësaj komune", ka thënë ai. Kryetari i BIK-ut në Drenas, Valon

Bequku, ka falënderuar zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian për vizitën që i ka bërë xhamisë së fshatit Zabel i Ulët dhe ka treguar për tolerancën fetare e cila ekziston në Komunën e Drenasit.



Bequku ka informuar Wielandin edhe për organizimin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Drenas, për shtrirjen e objekteve fetare dhe bashkëpunimin me institucionet komunale. Zëvendëspresidenti i PE-

së, i shoqëruar nga kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe ai i Skenderajt, Bekim Jashari, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kuro-ra me lule në Kompleksin Memorial në Prekaz.



# Narkoza e vizave - mit apo realitet (8)



Shkruan: Agron HOTI

## Kafshata e bukës first

Krahasimet gjithmonë sjellin pasqyrë më të qartë. Kosova nuk ka më shumë se 10 vjet shtet dhe kërkesat e BE-së janë që ne të reflektojmë në të gjitha drejtimet e mundshme, duke iu referuar më së shpeshti problemeve në sektorin e sundimit të ligjit. Por harrohet fakti se segmentet e shtetit ecën paralelisht, nuk mund të presësh sundim të avancuar të ligjit përballë një zhvillimi dhe rritjeje modeste ekonomike. A mund të thotë dikush që vendet e BE-së, 10 vjet pas Luftës së Dytë Botërore (LDB), kishin si preokupim kryesor sundimin e ligjit?

Absolutisht jo, viti 1955 (pra 10 vjet pas Luftës së Dytë Botërore) ishte një vit ku vetëm për sundim të ligjit nuk mendohej në Evropë. Kjo sepse gjendja e përgjithshme ekonomike dhe e sigurisë në Evropë ishte tepër e cenueshme dhe shtetet kishin prioritetet kafshatën e bukës dhe sigurinë e qytetarëve të tyre para çdo korrupsioni eventual apo krimi të organizuar. Bile-bile vendet e BE-

së vetëm pas vitit 1970 mund të konsiderohen si më të konsoliduara sa i përket sundimit të ligjit. Vetëm pas vitit 1970 filluan rritjen ekonomike, pra diçka që shkonte krahas me fuqizimin e sundimit të ligjit. Me fjalë të tjera, mos të pret dikush që Kosova si shtet i ri të lulëzojë në fushën e sundimit të ligjit e të ketë zhvillim të ulët ekonomik. Kjo nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës e nuk do të ndodhë as në Kosovë.

E të gjithë e dinë që rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, ka kaluar nga një sistem komunist në atë demokratik, ka kaluar nëpër 10 vjet luftë, ka humbur tregjet, është deindustrializuar, privatizimet kanë dështuar në pothuaj tërë botën komuniste përfshirë Kosovën dhe të gjitha këto kanë bërë që rajoni i Ballkanit të ketë përqindjet më të larta të emigracionit në Evropë. Me gjithë këto vështirësi, Kosova vazhdon të ketë një rritje ekonomike solide prej 4 përqindësh ndër vite, që është më e lartë sesa mesatarja e BE-së. Megjithëse është i qartë jo-proporcionaliteti për shkak të shkallës së zhvillimit.

Pse BE-ja dhe shtetet anëtare të saj po investojnë nëpër shtete që vijnë nga numri i madh i popullsisë në Amerikë Jugore dhe Azi e nuk po investojnë në asi përmasa në Ballkan?! Po subvencionet bujqësore që BE-ja dhe vendet anëtare u japin bujqve të tyre a nuk janë dërrmuese për ekonomitë e Ballkanit?! Ku mbeti

teoria e përparësisë krahasuese e David Ricardo, përmes së cilës dëshmohej se një shtet duhet të prodhojë diçka, për të cilën ka përparësi krahasuese me shtetin tjetër.

Sipas kësaj logjike, nëse BE-ja do ta mbështeste bujqësinë e rajonit dhe të ndërpriste subvencionet e veta për këtë sektor të ndjeshëm, atëherë prodhimi dhe eksporti jo vetëm se do të ishin shumë më të mëdha në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por edhe papunësia do të ishte më e ulët në rajon. Ka libra shkencorë e artikuj të panumërt që flasin për subvencionet e padrejta multimiliardëshe që vendet e pasura japin për bujqësitë e tyre, të cilat sigurojnë se dëmtojnë konkurrencën dhe rrjedhimisht dëmtojnë Kosovën, ekonomitë e Ballkanit dhe ekonomitë e tërë botës.

Pra, po të investohej me sinqeritet në Ballkan e Kosovë do të mbyllej shumë shpejt zbrazëtia e krijuar pas rënies së komunizmit dhe se rajoni nuk do të përballej me ikje të rinjve. Nëse vende të BE-së dhe BE-së nuk investojnë në Ballkan shkak i korrupsionit dhe krimin të organizuar, atëherë pse investojnë në Kinë, Indonezi, Brazil, Indi, Bangladesh, Pakistan, Iran, Rusi, Vietnam e shumë shtete të tjera, të cilat vijnë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar?!

Ne e kuptojmë se logjika e investimeve thotë që: "Vendi pranues, ndër të tjera, duhet të ketë fuqi punëtore të lirë", të cilën Kosova

nuk e ka nëse krahasohet me vendet e lartpërmendura, "konsum sa më të madh nga vendi pranues dhe rajoni", të cilin Kosova nuk e ka (sepse ka vetëm 1.8 milion banorë), "rajon me ekonomi prosperuese siç janë shtetet e lartpërmendura dhe projeksione zhvillimore afatgjata", edhe këtu rritjet ekonomike në Ballkan krahasuar me nivelin e ulët të investimeve të BE-së dhe trendet e ngadalta nuk mund të krahasohen me shtetet e lartpërmendura.

Por nuk mund ta kuptojmë kur na thuhet që shkak i korrupsionit nuk po investohet. Po, investimi prej 1.2 miliardë euro i firmës amerikane për ndërtimin e termocentralit të ri pse u bë kur paska pasur korrupsion, po ndërtimi i autostradave të reja të krahasueshme me vendet e BE-së pse po bëhet, po rritja ekonomike prej 4 deri 5 përqind më e larta në rajon (sipas Bankës Botërore) pse po ndodh nëse ka korrupsion dhe krim të organizuar?!

Të gjithë e dimë se kjo rritje, fatkeqësisht nuk bëhet nga sektori privat dhe se nuk e redukton pabarazinë sociale. Por nuk duhet harruar se investimet publike janë të pashmangshme, kur dihet që Kosova kishte trashëguar një infrastrukturë, e cila ishte më e pazhvilluara në Evropë. Sa i përket pabarazisë sociale, ajo ishte dhe është fenomen global, bile-bile edhe pse globalizimi në njërin anë ka kontribuar në rritjen ekonomike globale, ai në anën

tjetër, sidomos me 'eksplozimin' e teknologjisë informative, ka rritur monopolet dhe pabarazinë sociale.

Askush nuk mund ta mohojë korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë, sepse ky sindrom përpos që është rajonal ai ka edhe përmasa globale. Sigurisht që ne duhet të tregojmë përkushtim për reforma gjithëpërfshirëse, por në të njëjtën kohë na duhet të kujdesemi edhe për zhvillim ekonomik, sepse pa zhvillim ekonomik s'mund të sigurojmë perspektivë për qytetarët tanë.

Vlen të përmendet rasti i Gjeorgjisë Kaukaziane, e cila është "frontrunner" për reformë të administratës publike, përmirësim të hatashëm të shërbimeve publike dhe luftim të korrupsionit. Mirëpo, përkundër këtyre hapave të mëdhenj, Gjeorgjia ka ngecur në zhvillim ekonomik, pasi që që parametrat për zhvillim dhe rritje ekonomike janë tjerë dhe nuk varen tërësisht nga luftimi i korrupsionit.

Mjafton të shohim Kinën, Indinë, Turqinë, Brazilin etj. e shumë shtete të tjera (edhe pse këto nuk duhet të jenë model për Kosovën, por shërbejnë vetëm për ilustrim) të cilat vijnë nga korrupsioni dhe kanë rritje ekonomike që rivalizojnë pothuaj çdo shtet perëndimor. Kjo nuk do të thotë që Kosova duhet të ndalojë parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, përkundrazi duhet të tregohet shumë më e përkushtuar. (Vijon)

## MESAZHI NGA EVROPA



Nga Shkelzen UKEHAXHAJ

Do të vijë Herr Hahn!  
Erdhi Herr Hahn.  
Në gojë gjuhën mjaltë,  
Nën gëzof kish një jatagan.

Nga armiku ynë, andej erdhi.  
Nuk kërcënoi 100 %, po tha:  
Në çerekun e këtij shekulli,  
Vizat do t'jua jap!

Herr Hahn!  
Një "mik" i shtëpisë  
Apo veten e ndieni "sovrani"?  
Që të presim me bukë, krip e zemër,

E kemi traditë...  
Andej, kah ju sot vini,  
E kanë traditë,  
Gjithmonë fshehur e mbajnë një thikë...

Nëse thoni:  
Kemi dhënë me miliarda euro,  
Por edhe kemi punuar mirë,  
Atëherë ne jemi arkitekturë e juaja,  
E pra pse s'na merrni në gji?!

Pra ne e dimë dhe s'jemi të paditur,  
Se jemi këtu që nga antikiteti,  
Me trurin dhe shpirtin më të ndritur.

Që para Aleksandrit t'Olimpisë,  
E deri te Skënderbeu, jemi bijtë e korifenjve  
Që i shërbyen këtij dheu.  
Krenar për të kaluarën ndihemi,  
Për Evropën, në mos më tepër,  
Sa t'jerët kemi dhënë.

Edhe pse mijëvjeçarëve,  
Mbi ne ushtritë e huaja kaluan - nuk na shuan dot.  
Pellazgë e ilirë mbetëm,  
I pastër si uji e si majat e bjeshkëve kryelartë.

E kështu nëse i themi Evropës - Kontinenti i vjetër,  
Së bashku me të tjerët, këtu ishim,  
E s'kemi ardhur nga ndonjë vend tjetër.

Këtë ua kanë thënë shqiptarët

Dhe ju këtë fort mirë e dini.  
Ne jemi këtu, ku të parët tanë ishin  
Andaj këtu jetojmë,  
Kemi qenë dhe Evropës do t'i takojmë.

Ju, nga ne bëni me gisht,  
Sikur ne të jemi djalli,  
Po djalli që ju kërkoni  
Fshihet n'Serbi, bile nuk fshihet aspak!  
Ose ju doni t'i vini djallit "kapak"  
E ai djall lëviz brenda "teje" Herr Hahn,  
Që t'mos e vësh Herr Hahn,  
Ose je i verbër ose vetë je një djall!

Ne jemi të vetëdijshëm Herr Hahn,  
Për miqtë që na kanë përkrahur,  
Dhe në zemër këta i mbajmë,  
Por kemi pritur edhe të tillë:  
Që janë shitur për "miq"  
E punët që bënë treguan se ishin të ligj.

Pra, kemi pirë qumështin "e nxehtë" e jemi përvëlur,  
Andaj i fryjmë edhe kosit,  
Që t'mos jemi të hutuar...!

Na falni, Herr Hahn!  
Por në çerekët që kanë kaluar - siç e thamë  
Kanë ardhur miq të mirë...  
E keni sjellë edhe të tillë si H. Haekkerupi  
Dhe historitë e tyre,  
Ne i kujtojmë si shembuj, që s'duhën harruar!!!...



## Minatorët e "Trepçës" në grevë, kërkojnë rritje të pagave

MITROVICË, 3 JANAR - Punëtorët e minierës së "Trepçës" kanë hyrë në grevë. Ndërrimi i parë i këtyre punëtorëve nuk ka hyrë të enjten në minierë të punojë, po ashtu edhe ndërrimi i dytë e ka mbështetur ndërrimin e parë, duke vazhduar grevën. Arsyet e grevës janë

pakënaqësitë ndaj institucioneve shtetërore të cilat, sipas tyre, nuk përmbushën kërkesat e tyre. Anëtar i Kryesisë së Sindikatës së "Trepçës", Isuf Peci, ka thënë për "Klan Kosova" se greva ka filluar të enjten dhe do të vazhdojë deri të premten. "Kërkesa jonë e parë

është rritja e pagave deri 20 përqind, kërkesa tjetër është se pse bordi asnjëherë nuk është takuar me ne dhe kërkesa tjetër pse për Vitin e Ri nuk na janë dhënë 100 euro dhe një dhuratë si herëve të tjera", ka deklaruar Peci.

Po ashtu, arsye të tjera të kësaj

grevë janë edhe plotësimi i kërkesave të grevës së pezulluar para disa muajve, ndërsa pyetja tjetër e tyre është se: Si po bëhet pranimi i punëtorëve pa konkurs? Peci ka bërë me dije se të premten do të mbahet edhe një takim ku do të flitet për hapat e mëtejshëm.



## Top prioritetet ekonomike të Kosovës në vitin 2019

Krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë nga ekspertët të çështjeve ekonomike listohen si dy prioritetet më të rëndësishme në aspektin ekonomik për vitin 2019

PRISHTINË, 3 JANAR - Kosova si një vend me papunësi të lartë në mbi 30 përqind, sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe me rreth 3 miliardë euro import në vit kërkon, sipas ekspertëve, që institucionet të marrin masa konkrete në përmirësimin e këtyre dy aspekteve ekonomike. Naim Gashi, ekspert i çështjeve ekonomike, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se janë shumë çështje ekonomike të cilat kanë ngecur në Kosovë, por që çështja e papunësisë është një problem që duhet të adresohet nga autoritetet. "Kosova ka problem me shkallën e lartë të papunësisë dhe zhvillimin e pamjaftueshëm ekonomik. Në tre vjetët e fundit kemi pasur rritje ekonomike deri në rreth 4 përqind, por kjo nuk është e mjaftueshme nëse e marrim parasysh numrin e të rinjve të cilët futen në tregun e punës. Krijimi i vendeve të punës, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë top prioritetet të cilat duhet të jenë për vitin 2019", ka thënë Gashi. Me gjithë përparimet e shënuara, Kosova, theksohet nga ekspertët, nuk ka arritur të krijojë ekonomi të zhvilluar, të krijojë kushte më të mira për sektorin privat, investime të huaja, ndërkohë që vazhdon të përballet me një shkallë të lartë

të papunësisë dhe varfërisë. Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejd Bektashi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se prioritet në vitin 2019 duhet të jetë zhvillimi më i shpejtë dhe stabil i ekonomisë që, sipas tij, do të mundësonte edhe zgjidhjen e problemeve që janë grumbulluar në dy dekadat e fundit. "Në kuadër të këtij prioriteti do të ishte edhe stimulimi i prodhimit të vendore me qëllim që shumë mallra që tani importohen të prodhohen në kuadër të ekonomisë kombëtare. Prioriteti tjetër, që është edhe ekonomik, por edhe mund të konsiderohet si problem shoqëror, është luftimi i ekonomisë informale që po ngufat zhvillimin, po ashtu po pengon veprimin e konkurrencës që do ta mundësonte arritjen e rezultateve më efikase. Nga zvogëlimi i pjesëmarrjes së ekonomisë informale besoj se në masë të konsiderueshme do të rriteshin mundësitë që të luftohet korrupsioni i cili duhet të jetë prioritet në periudhën e ardhshme", ka thënë Bektashi. Sektori i prodhimit në Kosovë vazhdon të mbetet ende në shkallë të lartë. Ndërkohë, bizneset prodhuese në Kosovë gjatë vitit që lëmë pas janë ankuar në vazhdimësi për një ambient jo të favorshëm bizne-



sor. Bedri Kosumi, pronar i kompanisë "Pestova", e cila merret me përpunimin dhe prodhimin e patates, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se institucionet e Kosovës kanë bërë disa lehtësira fiskale gjatë vitit 2018 që, si të tilla, kanë pasur efekte pozitive në prodhim, por që institucioneve u mbetet ende punë për të bërë. "Që Kosova të arrijë të ketë një sektor më të qëndrueshëm dhe më të fuqizuar të prodhimit duhet të krijohet një ambient i

përshtatshëm afarist. Atë çka e ofrojnë vendet e rajonit duhet ta kemi edhe ne. Për të tërhequr investitorë duhet të krijohen kushte të mira për këta që janë këtu dhe sigurisht ata të tjerët pastaj do të vinin", thotë Kosumi. Në një raport të publikuar në fund të vitit të kaluar Fondi Monetar Ndërkombëtar parasheh rritje ekonomike për Kosovën gjatë vitit 2019 prej 4.2 përqindësh. Por, sipas FMN-së, kjo rritje mund të jetë më e

madhe nëse ka përparim në reformat, veçanërisht në tregun e punës dhe fushat e qeverisjes. Të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2019 në Kosovë janë në vlerë prej 2.3 miliardë eurosh. Ky buxhet prioritet i jep sistemit të drejtësisë, arsimit dhe shëndetësisë, kurse investimet kapitale që kapin vlerën e mbi 700 milionë eurove do t'i adresojnë nevojat në infrastrukturë rrugore, hekurudha, në trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhim të mbeturinave.

## Mehmeti: Banka e Diasporës mund të jetë shtyllë e ekonomisë së Kosovës

PRISHTINË, 3 JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se Diaspora në vazhdimësi është treguar mjaft e qëndrueshme dhe ka shërbyer si burim shumë i rëndësishëm i financimit të ekonomisë së Kosovës. "Përveç remitencave, të cilat deri në shtator 2018 janë në shumë prej 587.9 milionë eurosh, ekonomia e Kosovës përfiton mjaft shumë nga

diaspora edhe përmes kanaleve të tjera, siç janë shpenzimet e udhëtimit dhe investimet e huaja direkte. E tërë kjo flet për një kontribut shumë të rëndësishëm të diasporës tonë në zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë Mehmeti në një intervistë për "RTKlive". Sipas tij, BQK-ja do ta forcojë edhe më tutje rolin e saj për t'i siguruar ekonomisë së vendit një sektor financiar të qën-



drueshëm dhe me rol edhe më të madh në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit. "Këtë syno-

jmë ta arrijmë duke zhvilluar një politikë të shëndoshë të licencimit të institucioneve financiare, e cila, duke shtuar numrin e institucioneve financiare kredibile që operojnë në tregun tonë, do të mundësojë krijimin e kushteve për rritje të mëtejme të konkurrencës dhe zhvillim të qëndrueshëm të sistemit financiar të vendit. Zhvillimi i vazhdueshëm i funksionit rregullativ të BQK-së

do të vazhdojë të jetë prioritet i rëndësishëm, me çka synojmë t'i përgjigemi në mënyrë adekuate evoluimit të nevojave rregullative në sistemin financiar, si dhe t'u paraprijmë zhvillimeve të pritshme në këtë sistem në mënyrë që korniza rregullative të mos bëhet pengesë, por të ketë rol të rëndësishëm lehtësues në zhvillimin e sistemit financiar", ka thënë Mehmeti.



# USHTRIA E KOSOVËS DHE ALI AHMETI



**Ismet SYLEJMANI**

Urime për krijimin e USHTRISË SË KOSOVËS ilegali i famshëm, politikani atdhetar, drejtuesi i madh i Lëvizjes Popullore të Kosovës, themeluesi e komandanti i lavdishëm i UÇK-së, kryetari i BDI-së, Udhëheqësi i Popullit Shqiptar, shoku e mikim më i madh i luftës për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nga Serbia pushtuese i dashuri Ali Ahmeti!

Kosova për lirinë dhe pavarësinë e së cilës Ti bashkë me shumë shokë e bashkëveprimtarë, heronjë e dëshmorë, të plagosur e veteranë të çështjes së Atdheut, ke vepruar e luftuar pandërprerë kudo e në çdo çast,

me çdo mjet e në çdo formë të lejuar e të pranuar ndërkombëtarisht, më 14. 12.2018 edhe de jure, u bë me USHTRI të pranuar e të njohur nga SHBA- të dhe aleatë të tjerë të mëdhenj të popullit shqiptar!

Për të ardhur deri te kjo ditë e deri te ky moment i madh dhe historik, është dashur të luftohet, të veprohet e të punohet shumë, është dashur të oraganizohet e të ngjeshë radhët çdo organizatë patriotike e atdhetare me veprimtarë të mëdhenjë e të devotshëm, është dashur të vuajmë vite e shekuj të tërë nëpër burgjet e kazamatet serbe dhe krejt në fund për të ardhur deri te kjo datë e ditë historike e madhe dhe e lavdishme e krijimit dhe formimit të USHTRISË SË KOSOVËS, të pranuar e të njohur ndërkombëtarisht nga SHBA dhe aleatë të mëdhenj dhe miqë të popullit shqiptar, është dashur të derdhej gjak nga pionerët e Heronjëve dhe

Deshmorëve të Atdheut Fazli Grajçevci e Xheladin Hana, nga Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka, Rexhep Malaj e Nuhi Berisha, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu e shumë të tjerë dhe për të ardhur deri te EPOKA e madhe dhe e lavdishme e UÇK-së, që nga gjiu i saj nxorri Heronjtë e Kombit, Kryegjeneralët e Gjeneralët e lavdishëm, Komandantin Legjendar Adem Jashari dhe Jasharajt e lavdishëm dhe të pavdekshëm, Komandantin Luan Haradinaj e Haradinajt e lavdishëm dhe të pavdekshëm, Komandantin Lavdimadh Fehmi Lladrovci dhe Xhevën e Tij heroinë, Komandantët Zahir Pajazitin e Simbolin e thyerjes së kufirit Komandantin Agim Ramadani, Komandant Ismet Jashari-Kumanovën dhe Komandantin jo të vetëm nga Nëna Shqipëri Gjeneral Tahir Sinani e shumë të tjerë, e shumë të tjerë, e shumë të tjerë!...

Me krijimin e USHTRISË SË KOSOVËS, u shënuar një nga të arriturat më të mëdha, u bë realitet ëndrra e shekujve të gjeneralëve e ushtarakëve, udhëheqësve e diplomatëve të mëdhenjë të Atdheut tonë, të cilët që pas rënies së shtetit të Arbërit të Skënderbeut e deri të përfundimi i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të komanduar nga kryegjenerali Enver Hoxha, kurrë nuk e ndalën luftën titanike dhe heroike për ta bërë të mosvarme çdo pjesë të vendit të shqipeve, përfshirë edhe Kosovën si pjesën më luftarake të truallit shqiptar! I dashur shoku Ali Ahmeti, USHTRIA E KOSOVËS, Ty dhe shoket tuaj jo vetëm në Maqedoni, ju ka ushtarët themelues të saj, në USHTRINË E KOSOVËS të njohur e të pranuar nga SHBA-të dhe aleatët tjerë të mëdhenj, Ti zë vend nderi sepse



je njëri prej komandantëve të parë që hodhët firmën e madhe dhe historike, të shtrenjtë dhe të shenjtë në themelimin e paraardhësen e saj USHTRINË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS! Krijimi i USHTRISË SË KOSOVËS është ngjarje e madhe në të cilën janë të përfshiera me kontributin e tyre të gjithë brezat e popullit shqiptar që nga Skenderbeu e këndej! Në këtë varg të gjatë të këtyre brezave Ti je flamurtari ndër të parët e mëdhenj që mbajtën dhe mbajnë lartë flamurin e Atdheut që është i qullur me gjak lirie, përpjekje e heroizma titanike, që e bëjnë të lavdishme çdo ngjarje të vogël e të madhe për lirinë dhe çlirimin e popullit shqiptar dhe tokës së Atdheut tonë nga pushtues të ndryshëm, të largët e të afërt! Vazhdo shoq, Ti je në rrugën më të mbarë e më me shumë suksese, sepse Ti je në tokën shqiptare me më shumë histori

e ngjarje të së kaluarës se çdo pëllembe tjetër e Atdheut tonë! Në truallin shqiptar të Maqedonisë ku ke luftuar dhe je duke vepruar si Luan dhe po korrë fitore të mëdha, të gjithë e dijmë se nuk e ke të lehtë, por edhe besojmë se do të mbështjellësh me aureole lavdie të mdhe, historike e mitike!

Ti shqiptari i madh Ali Ahmeti, po rikthen e do të rikthesh vlera të mëdha për popullin dhe Atdheun, që në të kaluarën kurrë nuk janë imagjinuar e as shpresuar se do bëhen realitete ndonjherë!

Shpresojmë se një ditë Ti Udhëheqësi i Madh i Popullit Shqiptar, do të jeshë i dekoruar nga USHTRIA E KOSOVËS, edhe de jure Komandant Nderi!

USHTRIA E KOSOVËS DHE ALI AHMETI, janë fakt i madh historik dhe ngjarje që do të mbetet e shënuar me shkronja të arta në flamurin e kombit!

**Prishtinë, 29.12.2018**





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

TRANMERE - TOTTENHAM

GG3+

THE NEW SAINTS - NEWTOWN

1

LEVANTE - GIRONA

GG+

# Të fillojnë sa më shpejt punimet për ndërtimin e stadiumit kombëtar

Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka bërë me dije se në muajin mars do të fillojnë punimet për ndërtimin e stadiumit kombëtar, kurse analisti Genc Sermaxhaj mendon se këto punime duhet të fillojnë sa më shpejt që është e mundur dhe të ecin me ritëm të shpejtë për faktin se Kosovës i duhet një stadium me kapacitet të madh që përmbush kërkesat e të gjithë shikuesve që dëshirojnë ta përcjellin përfaqësuesen nga afër

**EPOKA ERE****Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 3 JANAR** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, në intervistën për numrin festive të gazetës "Epoka e re", ka folur për fillimin e ndërtimit të stadiumit kombëtar në Drenas. Numri një i futbollit të Kosovës ka bërë me dije se punimet për këtë stadium do të fillojnë në muajin mars dhe se ky stadium do të jetë ndër më të mirët në rajon. "Deri në muajin shkurt do të kryhen të gjitha procedurat e fizibilitetit dhe shpallja e tenderit dhe zgjedhja e fituesit se kush do ta punojë atë. Besoj në fjalët e ministrit të Sportit, se në mars do të fillojë ndërtimi i stadiumit kombëtar në Drenas, i cili do të jetë një nga stadiumet më të mirë në regjion", ka thënë Ademi.

Lidhur me këtë çështje ka folur të hënën për gazetë edhe analisti i

futbollit dhe dikur ish-lojtari i Përfaqësues së Kosovës, Genc Sermaxhaj. Ky i fundit ka thënë se është shumë e nevojshme që punimet për ndërtimin e stadiumit kombëtar të fillojnë sa më shpejt për faktin se në Kosovë në vitet e ardhshme do të vijnë kombëtare të mëdha dhe të gjithë kanë dëshirë t'i përcjellin nga afër ndeshjet e futbollistëve të Kosovës ndaj yjeve botërorë. "Pa dyshim se Kosovës i nevojitet stadiumi ku përfaqësuesja i zhvillon ndeshjet dhe pa dyshim se kapaciteti i tij duhet të jetë i madh që përmbush standardet që kërkohen dhe kjo do të krijojë vende të mjaftueshme për të gjithë ata që dëshirojnë ta përcjellin përfaqësuesen nga afër. Është me rëndësi që punimet për ndërtimin e këtij stadiumi të fillojnë sa më parë dhe punimet të zhvillohen me ritëm të shpejtë, pasi Kosova ka ngritje të madhe në cilësi dhe të gjithë po dëshirojnë t'i përcjellin ndeshjet e saj.

Me ndërtimin e këtij stadiumi nuk do të ketë tollovi për bileta. Në Kosovë do të vijnë kombëtare të mëdha dhe shikuesit do të dëshirojnë të jenë afër për t'i parë paraqitjet e yjeve botërore, prandaj ky stadium është i domosdoshëm", ka thënë Sermaxhaj. Përfaqësuesja e Kosovës eliminatorët për Kupën e Botës "Rusi 2018" i ka zhvilluar në stadiumin "Loro Boriqi" në Shkodër, kurse ndeshjet në kuadër të Ligës së Kombeve në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, por nga ndeshja në ndeshje interesimi i shikuesve ishte i madh për t'i përcjellë nga afër futbollistët "Dardanët", por shumë prej shikuesve nuk kishin rastin të sigurojnë biletat për të hyrë në stadium. Kjo ndodhi pasi numri i biletave nuk ishte i mjaftueshëm karshi kërkesave, kurse biletat gjithashtu në të shumtën e rasteve u keqpërdorën dhe u shitën me çmim të shumëfishuar në tregun e zi.

**SHKURT****Hadërgjonaj dhe Toma i thonë po Kosovës**

Vazhdojnë prurjet te Kosova, në prag të eliminatorëve të Evropianit 2020. Dy futbollistë cilësorë pritet t'i bashkohen skuadrës së drejtuar nga Bernard Chalandes. Bëhet fjalë për mbrojtësin e Huddersfield Townit, Florent Hadërgjonaj dhe mesfushorin e Sionit, Bastin Toma. Trajneri i "Dardanëve" ka konfirmuar se të dy futbollistët kanë pranuar ta veshin fanellën e përfaqësueses së Kosovës.

**Ballkani përforcohet me malazezin Edvin Kuç**

Skuadra e Ballkanit nga Suhareka është përforcuar me futbollistin Edvin Kuç, i cili është nga Mali i Zi. Skuadra e Ballkanit nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se futbollisti në fjalë është mesfushor nga Rozhaja dhe ka zhvilluar karrierën në Çeki, Bosnje dhe, së fundmi, ka qenë lojtar i Rudarit në Mal të Zi.

**Shumë skuadra e kërkojnë Zenelin**

Me tetë asistime e tre gola Arbër Zeneli ka qenë ylli i Heerenveenit në këtë edicion në elitën e futbollit holandez. E paraqitjet e tij kanë marrë vëmendjen e disa klubeve evropiane, raporton "Football-Oranje. Sipas këtyre raporteve, thuhet se Heerenveeni mund ta shesë Zenelin në afatin kalimtar të janarit, pasi për 23-vjeçarin kanë shprehur interesim klube nga Turqia e Italia, gjithashtu edhe Ajaxi.

**Përforcohet KB Bashkimi**

Kampioni aktual i Kosovës në basketboll, Bashkimi, ka nisur të mendojë për pjesën pranverore të kampionatit. Prizrenasit kanë bërë lëvizjen e parë duke përforcuar radhët e veta me një basketbollist amerikan. Bëhet fjalë për basketbollistin 24-vjeçar Lamar Wofford-Humphrey, i cili është i gjatë 206 cm dhe luan në pozitën 4-5. Në vitin e fundit lojtari ka luajtur për skuadrën e Omaha Mavericks në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtatgjati në sezonin e fundit në NCAA ka pasur një mesatare prej 8.2 pikëve dhe 4.8 kërcimeve për ndeshje. Ndryshe, Bashkimi ka paralajmëruar edhe përfundime të reja me basketbollistë cilësorë vendës dhe ndërkombëtarë. "Arpagjik't" aktualisht pozicionohen në vendin e pestë të renditjes tabelore, po aq sa ka edhe Trepça e vendit të katërt.

## Prishtina anulon pjesëmarrjen në Ligën Ballkanike

**PRISHTINË, 3 JANAR** - Klubi i Z Mobile Prishtina përmes një e-maili dërguar BIBL-it ka njoftuar se nuk do të jetë pjesë e kësaj lige pasi nuk ka arritur marrëveshje me FBK-në. Prishtina në këtë e-mail ka sqaruar se nuk ka pasur pajtueshmëri për

pjesëmarrje në Superligën e Kosovës në FIBA Europe Cup dhe në Ligën Ballkanike dhe për këtë shkak kanë vendosur ta anulojnë pjesëmarrjen në garën ballkanike. "Vjen si befasi për ligën pasi ne jemi pajtuar me klubin për pro-

gramin që përfshinte edhe ndeshjen e javës së ardhshme në Durrës. Programi ka ndryshuar disa herë me kërkesë të këtij ekipi dhe u është dërguar klubeve të tjera", thuhet në njoftimin e BIBL-it. "Drejtuësit e Ligës Ballkanike nuk

do të marrin anë apo të jenë pjesë e ndonjë konflikti mes klubeve dhe federatave. Detyra jonë është të ofrojmë garë të mirë basketbollistike në bashkëpunim të plotë me federatat dhe klubet", thuhet në këtë njoftim.





## Rexhbecaj preferon Gjermaninë para Kosovës dhe Shqipërisë

**WOLFSBURG, 3 JANAR** - Mesfushori Elvis Rexhbecaj ka refuzuar të luajë për Shqipërinë dhe Kosovën pasi ëndrra e tij është që ta përfaqësojë Gjermaninë. 21-vjeçari, i cili debutoi te Wolfsburgu në Bundesligë, po kalon një formë mjaft të mirë duke u aktivizuar në plot 11 takime me "ujçërit". Në një prononcim për

'SportBuzzer' ka treguar se ndihet gjerman dhe ëndrra e tij është ta veshë fanellën e "panzerave". "Kur isha dy vjeç kam ardhur në Gjermani me familjen time. Fillimisht jetonim në Brandenburg, me shumë vështirësi. Për ne fëmijët ishte e lehtë, por për prindërit tanë nuk dukej kështu. Babanë nuk e shikoja

asnjëherë në shtëpi sepse kishte shumë punë për të bërë. Nuk do ta harroj kurrë një histori, teksa shokët tanë i kishin këpucët e reja, ndërsa unë dhe vëllai im nuk e kishim këtë mundësi. Kur babai na erdhi një ditë me disa këpucë të reja sa shumë u gëzuam. Kur isha fëmijë me vëllanë praktikonim të bënim xhiro me biçikletë.

Gjatë çdo dite pavarësisht çfarë moti ishte. Të paktën 20 minuta për xhiro gjendesha në biçikletë. Tani nuk kam më probleme gjatë kohës kur vrapoj. Paratë po ndikojnë në futboll e kjo më shqetëson edhe mua. Dikur ishim futbolistë normalë, sot bëhet fjalë për miliona dollarë. Do të ishte ëndërr që të luaja për



Gjermaninë. Megjithatë, së pari duhet të kemi vazhdimësi, të tjerat do të vijnë vetë", ka thënë Rexhbecaj.

## Mavraj: Ja pse u largova nga Greqia dhe po rikthehem në Gjermani

**Tiranë, 3 janar** - Mërgim Mavraj në verë nënshkroi me Aris Selanik, por vendosi të largohet sepse ka ndjerë mungesë respekti ndaj tij. Kapiteni i kombëtares flet hapur dhe në njëfarë mënyre edhe akuzon. "Anulova kontratën me Arisin dhe do të firmos me skuadrën e Ingolstadt në Gjermani. Do të bashkohem me klubin në Spanjë, më pas për fazën përgatitore. Arsyeja pse largohem është sepse e kam ndier veten shumë të mosrespektuar. U folën shumë gjëra, por asnjëherë për futboll dhe për mua si futbollist. U fol për gjëra që nuk kanë të bëjnë me futbollin dhe paraqitjet në fushë, por thashetheme", ka thënë Mavraj. "Më rënduan si profesionist dhe si lojtar, pasi kur



vendosa të transferohem në Greqi e bëra për të ndihmuar një klub që besoi tek unë. Të gjitha më pas e vështirësuan situatën. U ballafaqova me gjëra joserioze. Mungoi mirësjellja edhe kundrejt punës sime. Këto janë shkaqet që

nuk më lejuan të jap më të mirën. Nuk mund të them se janë të pakënaqur për mua, pasi më kanë vlerësuar, por rryma të ndryshme kanë ndikuar. Këto gjëra, si futbollist, nuk i pranoj dot. Të priset emri dhe vlerat e

mia si lojtar. Nuk i shes dhe nuk i ndërroj vlerat për askënd. Nuk është komunikuar asnjëherë nga klubi që do të më largojë. Kjo është një arsye e madhe që u mërzi, pasi gazetat e morën vesh përpara të gjithëve. Madje, në një bisedë që kam pasur me trajnerin më tha se më shpejt iki unë sesa ti si lojtar, por në anën tjetër luhej pas krahëve. U mërzi shumë që emri im u bë si një lodër edhe në media... Këtu lindi ideja për t'u larguar dhe erdhi oferta nga Gjermania", ka deklaruar Mavraj për "Telesport". Lidhur me të ardhmen, ish-lojtari i Hamburgut dhe disa skuadrave të tjera në Gjermani, ka deklaruar: "Kisha oferta të ndryshme, edhe nga Emiratet, por profesionalizmi

dhe serioziteti gjerman janë pikat e forta që më kanë bindur gjithmonë, ndaj zgjedha Ingolstadt. Ndoshta duket si kthim mbrapa, por nuk është kështu. Më duket e njëjta histori me Hamburgun, kur vështirësitë ishin të mëdha, por mundësitë ekonomike nuk mungonin. Kështu e shoh edhe Ingolstadt, si një trampolinë që, pse jo, të ngjitem me ata drejt elitës në Bundesligë. Objektiv i është që të jap më të mirën për ta siguruar mbijetesën këtë sezon dhe besoj se mund t'ia dalim, pasi edhe te Hamburgu e arritëm atë gjë". Mavraj do të nënshkruajë për një vit e gjysmë me Ingolstadt. Klubi gjerman do ta paguajë klauzolën prej 300 mijë eurosh që Mavrajt ia lejon të largohet.

## 'L'Equipe' publikon formacionin ideal të 2018-s



**PARIS, 3 JANAR** - Ashtu siç ndodh çdo vit, e përditshmja franceze "L'Equipe" ka përpiluar formacionin ideal të vitit 2018 që sapo u mbyll. Reali i Madridit është ai që ka më shumë përfaqësues në këtë formacion, me tre të tillë: mbrojtësit Varane e Marcelo, si dhe mesfushorin Luka Modriç, që është edhe fituesit i "Topit të Artë" për vitin 2018. Ajo që të bie në sy është lënia jashtë e Antoine Griezmannit, kampion bote me Francën, por edhe fitues i Europa League e Superkupës Europiane me Atletico Madridin. Ky i fundit ka si për-

faqësues të vetëm në formacionin ideal të prestigjiozes "L'Equipe" portierin Jan Oblak. Sa i përket pjesës tjetër të skuadrës, reparti i mbrojtjes plotësohet nga Trent Alexander Arnold dhe Virgil Van Dijk të Liverpoolit. Në mesfushë, Modriçit i bashkohet francezi i Chelseat, N'golo Kante. Ndërkohë, Kylian Mbappe, Lionel Messi dhe Eden Hazard janë zgjedhur në formacionin ideal të "L'Equipe" si treshe e avancuar, në mbështetje të Cristiano Ronaldos së Juventusit, në rolin e sulmuesit të vetëm.

**Liridone Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m.m "Luciano Motroni" Prizren**

U bënë 19 vjet pa vëllain e dashur



## Mehmet B. Miftari

1942 - 2000

Edhe pas 19 vjetëve, dhembja që nuk të kemi pranë bëhet gjithnjë e më e madhe, ndërsa malli për ty sa vjen e shtohet. Ti vëlla Mehmet, do të jesh përjetësisht në zemrat tona.

**Me mall të pashuar dhe me lot e përkujtojnë motrat: Fatimja, Hyra, Zahidja si dhe vajza Sania nga Skenderaj.**





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada - Government*  
*Ministria e Administratës Publike*  
**Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration**  
**Agjencia e Shoqërisë së Informacionit**  
*Agjencia za Informaciono Društvo - Agency of Information Society*

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Administratës Publike shpall:

## KONKURS

### AGJENCIA E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT Drejtorati i Operimeve Qendrore dhe Sigurisë

**Titulli i vendit të punës:** Administrator i TI-së për siguri (1 vend punë);  
**Nr. ref.** RN00004251  
**Kategoria funksionale:** Niveli Profesional;  
**Koeficienti:** 7 (407.55€ bruto) + 450€ shtesë sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës;  
**Lloji i pozitës:** i Karrierës;  
**Orët e punës:** 40 orë në javë (me orar të plotë);  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Nëpunës i karrierës (pa afat të caktuar);  
**Periudha provuese:** dymbëdhjetë (12) muaj;  
**Vendi i punës:** Prishtinë, ndërtesa "ish Rilindja";  
**Nëpunësi raporton te:** Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë së TI-së;

#### Qëllimi i vendit të punës:

Realizimi i detyrave të sigurisë kibernetike duke përfshirë Administrimi i pajisjeve të sigurisë për TTK.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Zbaton politikat dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të TI-së;
- Menaxhon dhe administron Firewall-at, si dhe pajisjeve tjera të rrjetit qeveritar sipas nevojës;
- Instalon, administron dhe mirëmban softuerët dhe harduerët e sigurisë, duke përfshirë, por jo kufizuar, 'firewall-ët', IPS (Intrusion Prevention System), SIEM (Security Information and Event Management), antiviruset dhe sisteme tjera sipas nevojës;
- Kujdeset për konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e infrastrukturës së TI-së dhe informatave, duke zbatuar praktika të mira;
- Kujdeset për sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës komunikuese elektronike dhe të dhënave dhe sipas nevojës, ndihmon institucionet relevante në luftimin e krimit kibernetik (cyber crime);
- Kryen monitorime të trafikut të rrjetit, analizon dhe vendosë mekanizmat e sigurisë në sisteme;
- Përditëson dhe zbaton protokollet për vazhdimësinë e punës dhe të rimëkëmbjes pas fatkeqësive;
- Propozon projekte të reja për zhvillim, bazuar në nevojat dhe kërkesat e organizatës;
- Ofron këshilla teknike të sigurisë dhe përgatit raporte në baza periodike;
- Kryen detyra të tjera të deleguara nga Udhëheqësi i sektorit të Sigurisë dhe Udhëheqësi i Drejtoratit.

#### Kualifikimi dhe përvoja

- Diplomë universitare në shkencë kompjuterike.....E nevojshme;
- Përvojë pune në fushën e Teknologjisë Informativë me detyra specifike në rrjetë kompjuterike së paku dy (2) vite.....E nevojshme;
- Njohja e njërës gjuhë zrytare.....E nevojshme;
- Njohje të punës në Firewall, DNS, DHCP, IDS, IPS, VPN, catalyst, ASA Firewall dhe perimetër router.....E nevojshme;
- Njohuri mbi pajisjet kompjuterike të shfrytëzuesve, pajisjet periferike dhe pajisjet ndihmëse.....E nevojshme;
- Trajnime dhe certifikime në CCNA, CEH apo në ndonjë trajnim tjetër relevant.....E dëshirueshme;
- Njohja e gjuhës angleze.....E dëshirueshme;

#### Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Divizioni i Burimeve Njerëzore, kati III, zyra nr. 320, ndërtesa e "ish-Rilindjes", Prishtinë. Aplikacioni mund të merret edhe nëpërmjet ueb faqes së Ministrisë, në linkun: <https://map.rks-gov.net/institucion/Job-Vacancies/Konkurse.aspx?page=3>.

Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore, në tel: 038/20030002 ose 038/20030556, prej orës 08:00 – 16:00.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetim apo i dënuar për vepër penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda katër (4) ditësh.

"Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga data e publikimit në njëri nga gazetat ditore përkatësisht, prej datës 04/01/2019 deri me datën 18/01/2019.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada - Government*  
*Ministria e Administratës Publike*  
**Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration**  
**Agjencia e Shoqërisë së Informacionit**  
*Agjencia za Informaciono Društvo - Agency of Information Society*

Na osnovu Zakona br. 03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo i Uredbi br. 02/2011 o Procedura Rekrutovanja u Civilnoj Službi, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje:

## KONKURS

### AGENCIJA ZA INFORMACIONO DRUŠTVO Direkcija za Centralne Operacije i Bezbednost

**AGENCIJA ZA INFORMACIONO DRUŠTVO**  
**Direkcija za centralne operacije i bezbednost**  
**Naziv radnog mesta: Administrator za IT sigurnost (1 radno mesto);**  
**Br. ref.** RN00004251  
**Funkcionalna kategorija:** Profesionalni Nivo;  
**Koeficienta:** 7 (bruto 407,55 €) + dodatak 450 € prema odluci Vlade Republike Kosova;  
**Vrsta Pozicije:** Karijera;  
**Radno vreme:** 40 sati nedeljno (puno radno vreme);  
**Trajanje imcnovanja:** Službenik za karijeru (na neodređenom roku);  
**Probni period: dvanacst (12) meseci;**  
**Radno mesto:** Priština, zgrada "bivša Rilindja";  
**Službenik izveštava kod:** Rukovodilaca Sektora za IT sigurnost;

#### Cilj radnog mesta:

Realizacija zadataka kibernetičke bezbednosti, obuhvatajući Administraciju sigurnosne opreme za ITK.

#### Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi politike i procedurc za sigurnost IT sistema;
  - Upravlja i administrira Firewall-a, kao i druga mrežna oprema vladi prema potrebi;
  - Instalira, administrira i održava sigurnosni softver i hardver, uključujući, ali ne ograničavajući se na, 'firewall', (Intrusion Prevention System) (IPS), (Security Information and Event Management)(SIEM), antivirus i druge sisteme po potrebi;
  - Brine se o poverljivosti, integritetu i dostupnosti IT infrastrukture i informacija, sprovođenjem dobre prakse;
  - Brine se o sigurnosti i zaštiti elektronske komunikacione infrastrukture i podataka i, prema potrebi, pomaže relevantnim institucijama u oblasti kibernetičkog kriminala (cyber crime);
  - Sprovodi nadgledanje mrežnog saobraćaja, analizira i postavlja sigurnosne mehanizme u sistemima;
  - Ažurira i sprovode protokole za produženje rada i oporavka nakon katastrofe;
  - Predlaže nove razvojne projekte na osnovu potreba i zahteva organizacije;
  - Pruža tehničke savete za bezbednost i priprema izveštaje na periodičnoj osnovi;
  - Obavlja i druge poslove koje delegira Rukovodilac sektora Bezbednosti i Rukovodilac Administracija.
- Kvalifikacija i iskustvo:**
- Univerzitetna diploma kompjuterske nauke .....Potrebno ;
  - Radno iskustvo u oblasti Informativne Tehnologije sa specifičnim zadacima u mreži kompjuter najmanje dve (2)god. ....Potrebno;
  - Poznavanje jednog službenog jezika.....Potrebno;
  - Poznavanje rada na Firewall, DNS, DHCP, IDS, IPS, VPN, catalyst, ASA Firewall i peri metar router.....Potrebno;
  - Poznavanje kompjuterske za korisnike periferne uređaje i opreme pomoćni.....Potrebno;
  - Treniranje i sertifikacija u CCNA, CEH ili bilo kojoj drugoj relevantnoj obuci .....Poželjno;
  - Poznavanje engleskog jezika .....Poželjno;

#### Primanje i dostava aplikacija:

Ministarstvo Javne Uprave / Kancelarija Osoblja, bivša zgrada, "Rilindje" sprat III (treći), kancelarija br. 320, Priština, Kosovo; Za detaljnije informacije možete da kontaktirate na linku : <https://map.rks-gov.net/institucion/Job-Vacancies/Konkurse.aspx?page=3> ili kancelariju za osoblje na br. tel: 038 / 200-30-002 ili 038 - 200 -30 -556, od 08:00 – 16:00 časova.

Uz aplikaciju se prilažu primerci kvalifikacione dokumentacije, diplomirani sa univerziteta u inostranstvu prilažu sertifikat o nostrifikaciji diplome; dokaz o radnom iskustvu; dokaz da nije istražen ili osuđen za krivično delo (koje ne smije biti starije od datuma raspisivanja konkursa) i druge potrebne dokumentacije potrebne za posao.

Poslate aplikacije preko pošte, koji nose poštanski pečat na pošiljci napravljenoj posljednjeg dana roka za podnošnje zahteva, smatrati će se važećim i uzima će se u obzir ako dodu u roku od četiri (4) dana.

"Kosovska Civilna Služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja Aplikacije svih muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

"Ne većinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave, kao što je navedeno u članu 11, stav 3 Zakona br. 03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo".

Prijave podnesene nakon isteka roka ne prihvaćaju se i nepotpune prijave se odbijaju.

Samo odabrani kandidati u užem listu će biti kontaktirani.

Konkurs je otvoren petnaest (15) dana, od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina, odnosno od 04.01.2019. Do 18.01.2019.godine.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Javne Administracije  
Ministry of Public Administration

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ,L. Nr. 03/L - 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall :

## KONKURS

**Departamenti:** Standardeve Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ)

**Titulli i punës:** Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Mirëmbajtjes së Sistemeve (1 vend pune)

**Nr.ref.** RN00004252

**Kategoria funksionale:** Nivel Profesional

**Koeficienti:** 8

**Lloji i pozitës:** i Karrierës

**Orët e punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e emërimit:** Nëpunësi i karrierës (përhershëm) - periudha provuese: dymbëdhjetë (12) muaj

**Vendi i punës:** Prishtinë ndërtesa "ish Rilindja"

**Qëllimi i vendit të punës:** Planifikimi, organizimi, kontrolla dhe realizimi i menaxhimit të sistemeve dhe pajisjeve të makinerisë në ndërtesat qeveritare.

**Nëpunësi raporton te:** Udhëheqësi i Divizionit

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

1. Planifikimi, organizimi, kontrolla dhe realizimi i menaxhimit të sistemeve dhe pajisjeve të Makinerisë në ndërtesat qeveritare;
2. Të koordinoj dhe ngrit nivelin e bashkëpunimit dhe profesionalizmin në kryerjen e aktiviteteve të njësisë dhe më gjerë;
3. Të menaxhon, kontrollon dhe mbikëqyrë realizimin e obligimeve për kryerje të shërbimeve, liferime të mallrave të ndryshme, azhurimin e shënimeve në mënyrë periodike;
4. Të aplikoj udhëzimet administrative, udhëzimet e pajisjeve, procedurave, rregullave dhe ligjeve Teknike për të mundësuar menaxhimin e suksesshëm të sistemeve Makinerisë në ndërtesat qeveritare duke i harmonizuar me Ligjin për punën dhe Ligjin për shërbyes civil ;
5. Të përpilojë raporte periodike dhe sipas kërkesave;
6. Te bej menaxhimin e projekteve makinerisë;
7. Të kryej ndonjë detyrë tjetër sipas kërkesës nga mbikëqyrësi;

**Kualifikimi dhe përvoja**

- Fakulteti teknik drejtimi : Inxh i Makinerisë Termoenergjetikë;
- Së paku 3 vite përvojë pune profesionale Aftësi për punë në ekip, dhe përbushje të detyrave dhe punëve të vështira;
- Përvojë dhe aftësi të mira në planifikimin e menaxhimit të mirëmbajtjes të sistemeve dhe pajisjeve të makinerisë;
- Njohuri të mirë pune me kompjuter ( Word, Excel, Internet, Auto Cad);
- Njohuri për implementimin e sistemeve të BMS për menaxhimin e ndërtesave;
- Aftësi të mira komunikuese më gojë dhe me shkrim të gjuhës shqipe, e dëshirueshme e gjuhës angleze dhe serbokroate;
- Aftësi për punë në ekip, dhe përbushje të detyrave dhe punëve të vështira;

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Ministria e Administratës Publike/ Zyra e Personelit, ish-ndërtesa e „Rilindja“ kati III (tretë), zyra nr. 320, Prishtinë, Kosovë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në nr. e tel: 038 / 200-30-552 ose 038 - 200 -30 -002, prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë medoemos duhet ti sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontaktohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Javne Administracije  
Ministry of Public Administration

Na osnovu Zakona Civilne Službe Republike Kosova L. Br. 03/L - 149 Uredba Br. 02/2011god. O postupke Regrutaciji u Civilne Službe Republike Kosova , Ministarstvo za Javnu Upravu objavljuje :

## KONKURS

**Departman:** Standardi Politike Inženjering i Upravljanje Zgrada Vlade (DSPIUZV)

**Radno mesto :** Viši Zvaničnik za Menadžiranje Održavanja Sistema (1 radno mesto)

**Br. ref.** RN00004252

**Funkcionalna kategorija:** Profesionalni Nivo

**Koeficijenta:** 8

**Vrsta pozicije:** Karijera

**Radne časove:** 40 sati nedeljno

**Trajanje imenovanja:** Zvaničnik karijera (trajan) - probni period : dvanacst (12)meseci.

**Radno mesto:** Priština , zgrada štamparija “ Rilindja”

**Cilj radnog mesta:** Planiranje, organizovanje, kontrola i realizacija menadžiranja Mašinskim sistemima i opremom u vladinim zgradama

**Zvaničnik izveštava kod:** Rukovodilac Divizija

**Zadaci i glavni odgovornosti :**

1. Da menadžira, nadgleda, kontroliše realizaciju odobrenih planova za održavanje Mašinske opreme u vladinim zgradama;
2. Koordinira i povećava nivo saradnje i profesionalizma u vođenju aktivnosti jedinice i dalje;
3. Da menadžira, kontroliše i nadgleda ispunjavanje obaveza servisiranja, isporuke raznih dobara, periodično ažuriranje evidencija;
4. Da primenjuje administrativna uputstva, uputstva za opremu, procedura, pravila i tehničkih zakona kako bi se omogućilo uspešno upravljanje Mašinskim sistemima u vladinim zgradama, usklađivanje sa Zakonom o radu i Zakonom o civilnim službenicima;
5. Sastavlja periodične izveštaje i po potrebi;
6. Da menadžira Mašinske projekte;
7. Da izvrši bilo koji drugi zadatak na zahtev nadzornika;

**Kvalifikacija i radno iskustvo**

- Tehnički fakultet, smer : Inž Termoenergetske Mašinerije;
- Najmanje 3 godine stručnog radnog iskustva;
- Iskustvo i dobre sposobnosti planiranja i menadžiranja održavanja sistema i opreme Mašinerije;
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru ( Word, Excel, Internet, Auto Cad);
- Poznavanje sprovođenja BMS sistema o menadžiranju zgrada;
- Dobre usmene i pismene komunikacijske veštine na albanskom, poželjnom engleskom i srpsko-hrvatskom jeziku;
- Sposobnost za timski rad, kao i ispunjavanje zadataka i napornog posla;

**Prijem i predaja aplikacije :**

Ministarstvo Javne Uprave / Kancelarija personala ,bivša- zgrada „Rilindja“ III sprat, kancelarija br. 320, Priština , Kosovo; Za detaljne informacije mogu se obratiti Kancelariji Osoblja br. Tel: 038 / 200-30-552 ili 038 - 200 -30 -002, od 08:00 - 16:00.časova.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina .

Aplikacije poslate poštom ,koji nose poštanski pečat na pošiljci napravljen posljedni dan roka za podnošenje zahteva , smatra se važeća i uze će se u obzir, ako stigne u roku od 4 dana , aplikacije koje stignu nakon isteka roka i ne kompletirani neće se razmatrati uopšte .

„Kosovska Civilna Služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i očekuje aplikacije iz svih osoba muškog i ženskog svih zajednica na Kosovu. Aplikacija u prilogu dostavlja kopiju dokumentaciju o kvalifikaciju , iskustvo i ostalu potrebnu dokumentaciju , za to radno mesto za koje ste se pojavili“.

Kandidati koji će biti selektirani i pozvani na intervju obavezno trebaju doneti original okumenta na uvid.

Samo izabrani kandidati u užem listu će biti kontaktirali .





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Administratës Publike  
Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration

## KONKURS

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall konkurs për këtë vend pune:

**Titulli i vendit të punës:**

Kryeshef Ekzekutiv në:

- Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë/Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (1).

**Paga mujore:** 1.171.17 € bruto.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Siguron këshilla të politikave për Ministrin; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të Agjencisë të zbatohen në mënyrë efektive dhe efektive; siguron që masat zbatuese të Agjencisë të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave; menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të Agjencisë; menaxhon financat dhe burimet e tjera të Agjencisë; menaxhon rrjedhën e informacionit në Agjenci dhe koordinon raportet e Agjencisë me organet e tjera vartëse administrative etj.
- Përkrahimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësitë të punës për këtë pozitë mund të gjeni në linkun <http://map.rks-gov.net/getattachment/2c956b17-b2ba-459f-8131-c240e190cfe3/.aspx>

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedurat e konkurrimit:**

- Konkurrimi për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është i hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

**Shkollimi i kërkuar:**

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e preferuar në fushat që ndërlidhen me punën e Agjencisë përkatëse.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Duhet të kenë shkathësi në përcaktimin dhe arrijtjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; njohuri bazike në programet e kompjuterit; standarde të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë.
- Së paku 8 vjet përvojë pune profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues pas diplomimit në universitet.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njoftohen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përgjithshëm do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

- Përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

- Mandati për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është 3 vjet.

**Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit.

**Paraqitja e kërkesave:**

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III, ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.rks-gov.net>.
- Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetim apo i dënua për veprë penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.
